



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Arsim Parashkollor ”
“Universiteti Europian i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr Robert GJEDIA

Dr. Pranvera PUKA / KRAJA

Shtator / 2022

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ Arsim Parashkollor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 541, datë 10.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2018-2019 3 studentë; 2019-2020 2 studentë; 2020-2021 0 studentë; 2021-2022 0 studentë;
19	Komente / të tjera:	Shkresë e UET me nr. 78/104 prot, datë 21.07.2022 *

* Sipas kësaj shkrese, pas finalizimit të akreditimit të programit të studimit, UET do ti drejtohet MAS për të deklaruar mbylljen e këtij programi bazuar në aktet ligjore në fuqi.

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u orientua së pari nga shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit European të Tiranës (në vijim UET) dhe së dyti sipas aktiviteteve të realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet UET dhe ASCAL. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor në “Arsim Parashkollor” i licencuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas vlerësimit pozitiv nga ekspertët e fushës: Urdhër Nr. 541, datë 10.09.2018 të MASR (Ref. Nr. 54).¹

Programi i studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” i përket ciklit të parë të studimeve dhe ofrohet me kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike, me 180 ECTS.

Programi ofrohet prej Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve (DPES), pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale (FSHHEA), sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 528, datë 04.09.2018², “Për riorganizimin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në Universitetin European të Tiranës”, ku në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare “Diplomë Bachelor” në “Arsim Parashkollor” (BA – Arsim Parashkollor).

Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program i ciklit të parë “*Bachelor*” përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2021-2022 është 0 studentë
- Për vitin akademik 2020-2021 është 0 studentë
- Për vitin akademik 2019-2020 është 1 studentë (1 i transferuar)
- Për vitin akademik 2018-2019 është 1 studentë (2 tëtransferuar)

Gjithsej të diplomuar 3 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

¹ UMASR Nr. 541, datë 10.09.2018 “Për hapjen e programit BA Arsim Parashkollor.

² UMASR Nr. 528, datë 04.09.2018 “Për riorganizimin e FSHHEAL në UET”.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë nga ana e programin e studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Arsim Parashkollor”. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc.Dr. Robert Gjedia dhe Dr. Pranvera Puka/Kraja dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL Znj. Aleksandra Xhamo.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhër Nr. 541, datë 10.09.2018 të MASR (Ref. Nr. 54)³;
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017;

Aktivitet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë marrë nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” (shkrut 2022), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit, i cili ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. etj.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë së Studimeve Master;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentëve;
- Takim me Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Projekteve për Kërkim;
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë;

³ UMASR Nr. 541, datë 10.09.2018 “Për hapjen e programit BA Arsim Parashkollor.

- Takim përfundimtar me Përgjegjës të Departamentit;

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Nga ana tjetër, si pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, u realizua:

Vëzhgimi i mjediseve

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm vëzhgoi mjediset mësimore që ishin në dispozicion të programit të studimit, si: auditorë, laboratorë të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve dhe literaturës së bibliotekës. Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, si dhe nga puna në ekip të vlerësuesve të jashtëm me RVB dhe evidencat është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.07.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/74 Prot, datë 12.07.2022. Universiteti Europian i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 21.07.2022, me anë të shkresës me Nr. 78/104 Prot, datë 21.07.2022, "Komentet lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Arsim Parashkollor”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I. 1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të UET rezulton se veprimtaria e tij bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none">- Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;- Aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;- Dokumentet bazë rregullatore të institucionit si Statuti i UET”, planet strategjike të miratuara, si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të lidhura me to. <p>Nga analiza e tyre vihet re se të gjitha këto dokumente janë të hartuara në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, si edhe në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon marrëdhëniet në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.⁴</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Rezulton se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” mbështetet në misionin e UET, i cili është është t’u japë studentëve një edukim cilësor.⁵ Nga ana tjetër programi përfshin njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit, si formim qytetar të përgjithshëm; aftësi bazë për punë kërkimore; aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; aftësim për promovim personal, të cilat ruajnë vlerat akademike, kulturore dhe kombëtare.</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Në statutin e UET <i>neni 6</i>, citohet se: “Programet e studimit janë përputhje me realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit programi i studimit synon formimin e aftësive të veçanta për një llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh”.⁶ Nga shqyrtimi i Programit të studimit BA në Arsim Parashkollor vihet re si ai është hartuar në përputhje me</p>

⁴ Plani Strategjik 2015-2020.Plani Strategjik UET 2021, Vizioni.

⁵ Statuti UET, Neni 6, pika 6.2.

⁶ Statuti UET, Neni 6.

	qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë. Ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Rezulton nga analiza e Strategjive të kërkimit (2017-2020) dhe (2021-2025) të UET se programi i studimit është hartuar në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. ⁷			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I. 2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Bazuar në <i>pikën 6.3 të nenit 6</i> të statutit të UET, rezulton se Programi i studimit BA në “Arsim Parashkollor”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET. Ai është konform objektivave strategjike për zhvillimin. ⁸
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Siç theksohet në dy planet e zhvillimit strategjik të UET 2015-2020 dhe 2020-2021 përkatësisht në <i>pikat nr.3 dhe nr 3.3</i> , evidentohet se drejtimit prioritar akademike janë të përcaktuara në dokumentet bazë të institucionit, dhe edukimi bën pjesë në drejtimit e hershme prioritar. ⁹ , si konstatohet se në dekadën e tij të dytë, UET-i u zgjerua me disa fusha të reja studimi në të cilat ofron programe studimi, si shkencat humane, artet, inxhinieria, arkitektura dhe shkencat mjekësore teknike, për të akomoduar më mirë kërkesat që vijnë nga studentët, por edhe tregu i punës.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit	Nga analiza e dokumentacionit të Programit ¹⁰ evidentohet se ai është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit, si pjesë e fushës së edukimit, që mbulohet nga Departamenti i Psikologjisë,

⁷ Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.

⁸ Statuti UET, Neni 6, pika 6.3.

⁹ Plani Strategjik 2015-2020; Plani Strategjik UET 2021, Prioritetet.

¹⁰ Programi i studimit BA Arsim Parashkollor.

akademike të institucionit.	Edukimit dhe Sporteve dhe se ai respekton kriteret ligjore, përkatëse ¹¹ , ku lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I. 3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit (<i>pika 3.3 e saj</i>), rezulton se është i organizuar në mënyrë që studenti të marrë formimin e duhur, shkencor dhe metodologjik, si dhe kompetencat e domosdoshme të mësuesit të arsimit parashkollor. ¹² Po ashtu në këtë rregullore kompetencat që synohen të formohen për studentët u krijojnë atyre mundësi punësimi në përfundim të studimeve, të cilat përcaktohen në <i>faqen 8</i> të kësaj rregulloreje. ¹³
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve	Evidentohet një kulturë pune lidhur me analizat e tregut kur aplikohen programe studimi bashkë me dokumentacionin përkatës të tyre. Për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, UET ka krijuar Bordet e Tregut të Punës në çdo departament dhe konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, ku Drejtuesi i departamentit është përgjegjës në këtë organizëm. Rezulton se Departamenti kryen studime në vijimësi të tregut të punës dhe analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. ¹⁴ Konstatohet se është ngritur shoqata UET ALUMNI, e cila mban kontakte me studentët e diplomuar të programeve të studimit, duke përpunuar të dhënat statistikore në lidhje me shkallën e punësimit të tyre. ¹⁵

¹¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL.

¹² Rregullore e programit të studimit BA Arsim Parashkollor, pika 3.3.

¹³ Rregullore e programit të studimit-BA Arsim Parashkollor, Aneks, fq.8.

¹⁴ Statuti i UET, neni 18.4; Dokumenti i diskutimeve në Bordin e Tregut të Punës; Raporti i përfitimeve nga

marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹⁵ Monitormi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre – Edukim.

të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.									
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>Siç është përmendur edhe në komentin e Standardit I.3.1, rezultatet kryesore të pritshme të të nxënit¹⁶ të programit të studimit BA për “Arsimin Parashkollor”, për studentët që përfundojnë me sukses programin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë konceptet themelore në fushën e edukimit parashkollor; - të reflektojnë mbi filozofinë e edukimit tradicional dhe atë të avancuar me “në qendër fëmija”; - të shpjegojnë procesin e edukimit parashkollor, familjar dhe parashkollor të institucionalizuar. - të reflektojnë për vlerat e edukimit parashkollor në shoqëri, dhe forcojnë partneritetin prindër-fëmijë dhe komunitet-fëmijë; - të krijojnë një filozofi personale të avancuar për edukimin parashkollor; - të demostrojnë aftësi të mendimit kritik dhe të diagnostikimit të problemeve të ndryshme në mësimdhënie dhe të nxënë; 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I. 4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Rezulton nga shqyrtimi i evidencës së personelit akademik¹⁷ se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, i cili është njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, sipas Urdherit Nr. 528, date 04.09.2018.</p> <p>FSHHEAL për vitin akademik 2021- 2022 ka 57 pedagogë gjithsej, nga të cilët 41 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 5 kanë titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesorë i</p>

¹⁶ Rregullore e programit të studimit_BA Arsim Parashkollor, pika 3.3 dhe aneks fq.2.

¹⁷ Te dhena për stafin e fakultetit dhe departamentit përgjegjës.

	<p>Asociuar”, 10 kanë gradën Dr., dhe 22 Asistent Lektorë me Msc, dhe 16 janë personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Ndërsa Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ka 15 PAE nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë i Asociuar”, 4 kanë gradën Dr., dhe 8 Asistent Lektorë me Msc, dhe 6 PAK.¹⁸ Evidentohet se stafi ka kualifikimet e dhura për të mbular këtë program.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe referimi prej takimeve gjatë vizitës në Institucion, konfirmuan se fusha e programit të studimit, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale¹⁹. Programi i studimit Bsc në “Arsim Parashkollor” i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Emërtimi i programit është në koherencë me atë të njësisë bazë dhe kryesore.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave rezulton se programet e studimit që ofron UET kanë përputhje midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të Departamentit përgjegjës për programin e studimit. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve.²⁰ Departamenti ofron 8 programe gjithsej, 3 Programe të ciklit të parë, 2 programe të ciklit të dytë MP dhe 3 programe të ciklit të dytë Msc.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I. 5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione,

¹⁸ Te dhëna për stafin e fakultetit dhe departamentit përgjegjës.

¹⁹ Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësi përgjegjëse/kryesore.

²⁰ Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga njësi përgjegjëse.

kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në Rregulloren e UET²¹ vihet re një ndarje e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, të cilat delegojnë detyrat dhe përgjegjësitë midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga Departamenti. Po ashtu aty janë të përcaktuara roli i përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grupit mësimor/koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Evidentojmë se UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit, si edhe me aktorë të tjerë të institucioneve vendase e të huaja, me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve. UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për Psikologji. Referuar RVB rezultojnë se UET zbaton 95 marrëveshje, me IAL kryesisht në Europë.²² Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike. Nga ana tjetër institucioni ka lidhur 5 marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave.²³ Marrëdhëniet e bashkëpunimit mundësojnë realizimin e praktikave profesionale si element kryesor sëbashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve.²⁴</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimave nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion</p>	<p>Nga shqyrtimi i formularit të vetëvlerësimit të praktikës nga studentët rezultojnë se çdo vit akademik praktikat vlerësohen nga një ekip i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari²⁵ ku analizohet efektshmëria e realizimit të tyre, si dhe përcaktohen nevojat për përmirësim të vijueshëm.</p>

²¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, 17, 18, 21, 22; Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit. Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit.

²² <https://uet.edu.al/en/inter-institutional-agreement/>

²³ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. Tabelat permbledhese per Aneks RVB-Tabela 5. Marrëveshjet e bashkëpunimit.

²⁴ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese të UET.

²⁵ Formatu B.1.4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës nga student.

të realizimit të programeve të studimeve.	Ndërkohë Departamenti harton raport të përfitimeve prej marrëveshjeve të bashkëpunimit. ²⁶			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Evidenca “ <i>Mbi praktikën profesionale</i> ” na jep të dhëna se ka një bashkëpunim me punëdhënësit për kryerjen e praktikave profesionale përmes marrëveshjeve të shkruara, por jo e detyrueshme. Ky bashkëpunim rregullohet nëpërmjet marrëveshjes ku paraqiten detyrat dhe roli i partnerëve të përfshirë në këtë proces, brenda apo jashtë institucionit. ²⁷			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Evidentohet se institucioni ofron trajnime për studentët e tij të diplomuar dhe këtë e ofron dhe aty ku ata janë të punësuar, si dhe për ata që janë në proces studimit. ²⁸ Marrëveshjet e shumta me institucionet dhe partnerët e lehtësojnë këtë proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II. 1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Specifikimet për Programin e Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” jepen në dosjen e plotë të Programit të Studimit. ²⁹ Programi i studimit BA në “Arsimin Parashkollor” është i organizuar në lëndë dhe module me gjithsej 180 kredite (ECTS) dhe me kohëzgjatje 3 vjet, i ndarë në mënyrë të barabartë me 60 kredite në një vit akademik. Programi i

²⁶ Raport i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

²⁷ Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.

²⁸ Trajnime te metejshme profesionale per studentet e diplomuar.Certifikate mentorshipi.Modul Trajnimi.

²⁹ Kurrikula e programit.

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>studimit i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është në përputhje me nenet 69-73 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si edhe me VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit³⁰ konstatohet se ky program u jep mundësi studentëve që përveç formimit të tyre bazë në fushën e mësuesisë, të mund të pajisen me njohuri e aftësi praktike në nënfushat e kërkuara për zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijëve të grupmoshës përkatëse, në arsimin parashkollor. Programi i Studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” ka për qëllim t’ju japë studentëve njohuri bazë teorike dhe praktike në fushën e Mësuesisë për Arsimin Parashkollor. Këto njohuri merren përmes kombinimit të një sërë lëndësh:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të formimit të përgjithshëm, në fushat: Filozofi, Gjeogafi, Edukim qytetar dhe figurativ, Edukim artistik, Edukim Fizik, Edukim mjedisor, Edukim special, Kujdesi për higjenën, për Arsimin Parashkollor; - të formimit karakterizues, në fushat: Matematikë, Gjuhë shqipe, Letërsi për fëmijë, Psikologji, Njohuri mbi Historinë, Pedagogji, Shkencat e Natyrës, Teori të komunikimit, ekonomi, statistikë; - të Formimit të Ngjashme ose/dhe Integruese me disiplinat karakterizuese në fushat: Shkrim akademik, Zhvillim Social, Etika; - veprimtari Formuese me Zgjedhje të ofruara nga Institucioni të cilat mund të zgjidhen nga vetë studentët në fushat si: Bazat e informatikës, Hartim projektsh, Gjuhë angleze; - përmes Praktikave Profesionale;
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentit për ndërtimin e programit të lëndës dhe litareturës evidentohet se përmbajtja e njohurive është brenda fushës dhe dijes së arsimit parashkollor dhe kufinjve të disiplinave përkatëse etj³¹. Programi BA “Arsim Parashkollor” synon, ta pajisë studentin me³²:</p>

³⁰ Kurrikula e programit.

³¹ Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, pika A.III.4.1.1.

³² Rregullore e programit të studimit_BA Arsim Parashkollor, pika 3.3.

<p>akademike të fushës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; - Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; - Formim të përgjithshëm qytetar; - Aftësi bazë për punë kërkimore; - Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; - Aftësim për promovim personal;
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Konstatohet se programi i studimit të ciklit të parë, nëpërmjet njohurive që u përcjell studentëve,³³ synon dhe formim të kompetencave të avancuara, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të inkurajojnë fëmijët të përdorin gjuhën si mjet komunikimi; - të krijojnë mundësi për inkurajimin e bashkëveprimit fëmijë-fëmijë; - të inkurajojnë pavarësinë e fëmijës sipas moshës dhe zgjedhjeve të zhvillimit; - të jenë të aftë të nxisin motivimin e brendshëm për t'i ndihmuar fëmijët të njohin botën që i rrethon, të fitojnë njohuri, aftësi dhe vlera; - të krijojnë aftësi kërkimore dhe statistikore për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për zhvillim të fëmijës;
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Evidentohet nga rregullorja e programit³⁴ të studimit se ky program pasqyron ndryshimet dhe kërkesat ligjore të rrjedhura nga zbatimi i Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, programi i studimit përfshin në përgjithësi të gjitha elementet që parashikon si të detyrueshme VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; - objektivat formues dhe kompetencat profesionale; - veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; - plani mësimor; - kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; - programet lëndore (Syllabus-et);

³³ Rregullore e programit të studimit_BA Arsim Parashkollor, pika 3.3.Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës pika A.III.4.1.1.

³⁴ Rregullore e programit të studimit_BA Arsim Parashkollor

	<ul style="list-style-type: none"> - profili i programit; - diploma dhe suplementi; <p>Në rregulloren e programit të studimit nuk përfshihet vetëm Kodi i Etikës i programit të studimit, element ky i detyrueshëm i përcaktuar sipas VKM-së nr. 879, datë 18.12.2019.</p>								
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave, si: Rregullore e UET, Rregullore e Programit të Studimit rezulton se lëndët e programit të studimit janë të organizuara në 5 kategori disiplinash (A-E)³⁵. Studenti merr 35 ECTS nga lëndët bazë, 96 ECTS nga lëndët karakterizuese, 24 ECTS nga lëndët ndërdisiplinore të profilit, 18 ECTS nga lëndët plotësuese dhe 7 ECTS nga detyrimet përmblylëse i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome për studentët me mesatare 8.5.³⁶ Ngarkesa normale është 60 kredite në vit, e ndarë në mënyrë të barazpeshuar me nga 30 ECTS për semestër. Studentët që përfundojnë studimet në këtë program diplomohen me të paktën 180 ECTS. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.³⁷</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II. 2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti European i Tiranës është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 246, datë 24.07.2009, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 46, datë 05.07.2019, të Bordit të Akreditimit.</p> <p>Programi i studimit Bsc në Arsim Parashkollor po kalon proces për herë të parë në kuadër të akreditimit.</p>

³⁵ Rregullore UET, neni 16. Kurrikula e programit të studimit/Kurrikula sipas veprimtarive formuese

³⁶ Rregullore UET, neni 39.

³⁷ Plani mësimor i programit Bachelor Arsim Parashkollor.

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Rezulton se Koordinator për programin Bsc në Arsim Parashkollor është Prof.As.Dr. Tomi Treska, bazuar në vendimin, Nr. 95, date 03/12/2018, në të cilin paraqiten dhe detyrat kryesore të koordinatorit, por dhe në aktet rregullatore të UET.³⁸ Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit të Njësisë kryesore³⁹, të departamentit, si dhe tabelat përkatëse për to, se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale përmbush detyrimet ligjore sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor”. Ky fakultet është i përbërë nga 3 Departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit; 2. Departamenti i Psikologjisë Edukimit dhe Sporteve; 3. Departamenti i Arteve të Aplikuara; <p>Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që janë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Prof.Asoc.” dhe Përgjegjësi i Departamentit mban titullin akademik “Prof.Asoc.”</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale në vitin akademik 2021-2022 ka në përbërje të tij 57 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 41 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 16 staf akademik me kontratë, (PAK).⁴⁰</p> <p>Departamenti organizohet në grupe mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore, kurse takime e punës zhvillohen çdo të martë të javës.⁴¹</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit,</p>	<p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022.⁴²</p>

³⁸ Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit. Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit.

³⁹ ANEKS: Tabelat përmbledhese-Tabela 1.

⁴⁰ Te dhena për stafin e fakultetit dhe departamentit përgjegjës.

⁴¹ Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2.

⁴² Te dhena për stafin e fakultetit dhe departamentit përgjegjës.

<p>përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p><u>Departamenti i Shkencave Humane dhe komunikimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 9 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada; - 1 PAK, 1 me gradë; 			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p><u>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 15 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 6 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Arteve të Aplikuara:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 17 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 9 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve që është përgjegjës për programin e studimit për katër vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:^{43 44}.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (12 PAE / 9 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 7;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (11 PAE/ 10 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 6 / 7;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (16 PAE / 9 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 6;</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (15 PAE / 6 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 4;</p> <p>Departamenti organizohet në grupe mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore ,kurse takime e punës zhvillohen çdo të martë të javës.^{45 46}</p> <p>Përsa më sipër GVJ konstaton se të tre njësitë bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHHEAL) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik; - organizimin dhe strukturën akademike; 			
<p>Shkalla e përbushjes së</p>	<p>Nok</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet</p>

⁴³ Te dhena per stafin e fakultetit dhe departamentit pergjegjes.

⁴⁴ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 1.

⁴⁵ Te dhena per stafin e fakultetit dhe departamentit pergjegjes.

⁴⁶ Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2.

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II. 3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga vëzhgimi në website të institucionit⁴⁷ https://uet.edu.al/bachelor/; https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/BA-Arsim-Parashkollor.pdf, shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se fakulteti dhe departamenti, zotërojnë informacionin e plotë lidhur me programin e studimit, siç është plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, informacion mbi rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij, të cilat gjenden në sistemin LMS.⁴⁸</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe i programeve lëndore të programit të studimit konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Çdo lëndë vlerësohet me kredite, çdo lëndë ka të përcaktuara orët javore, orët në auditor dhe jashtë auditorit.⁴⁹ Bazuar në Rregulloren mësimore të UET, programet e studimit organizohen në 5 kategori disiplinash⁵⁰, të cilat kategorizohen, si më poshtë:</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme;</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore;</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje;</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri</p>

⁴⁷ <https://uet.edu.al/bachelor/>; <https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/BA-Arsim-Parashkollor.pdf>

⁴⁸ Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS

⁴⁹ Kurrikula e programit (Ref. Nr. 14); Rregullorja e programit, pika 3.

⁵⁰ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 16 pika. 16.2.

	<p>informatike, praktika profesionale;</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues;⁵¹</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Arsim parashkollor” është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS.⁵²</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i Studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” përmban edhe Planin Mësimor të Programit të Studimit. Plani mësimor përmban kodin e lëndës, emrin e lëndës, kreditet, ngarkesën mësimore në orë brenda dhe jashtë auditorit. Ndarja e orëve mësimore në auditore në orë për leksione, orë për seminare, orë për ushtrime për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, bazuar në numrin e krediteve të çdo discipline. Çdo krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Gjatë një viti mësimor, sasia e krediteve të përfituara është 60. Gjithsej, orë mësimore gjatë gjithë ciklit 3 vjeçar të studimit janë 4500. Theksojmë se orët maksimale për të tre vitet e studimit janë 4500, nga të cilat 1798 janë orë brenda auditorit, ndërsa 2702 orë janë të përcaktuara si orë jashtë auditorit. Rezulton se raporti orë jashtë auditorit kundrejt orëve të përgjithshme është 60.0%. Ky raport rezulton se i plotëson kërkesat e pikës 2.1/ç të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Plani mësimor i program jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit.⁵³</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të Rregullores së Programit të studimit vihet re se aty janë përcaktuar kriteret për pranimin e studentëve (pika 2). Referuar RVB për programin e studimit, pranimi i studentëve është rregulluar nëpërmjet VKM, Nr. 216, datë 20.4.2018, ku përcaktohet se studentët të cilët duan të vazhdojnë studimet në Universitetin Europian të Tiranës, në programin Bsc. Arsim Parashkollor, duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare 7 për vitin akademik 2018-2019, ndërsa për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021 e në vijim, pranohen kandidatë me mesatare mbi 7.5. Në Rregulloren e</p>

⁵¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, pika 16.2/ Kurrikula e programit

⁵² Kurrikula e programit; Plani mësimor i programit. Rregullorja e programit, pika 3.

⁵³ Plani mësimor i programit; Rregullorja e programit, pika 5 dhe 6.

	Programit të Studimit, janë të përcaktuara të gjitha kriteret që lejojnë transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, në programin Ba Arsim Parashkollor (pika 9). ⁵⁴			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Konstatohet se programet lëndore (syllabuset) për çdo lëndë të Programit të Studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor”⁵⁵, janë hartuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, si edhe përfshijnë midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës; - kreditet dhe kodin e lëndës; - adresën elektronike të pedagogut; - përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit; - konceptet themelore dhe temat e lëndës; - formën e kontrollit të dijeve dhe frekuentimin; - kontrollin e vazhdueshëm, literaturën bazë dhe atë plotësuese; - vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës; <p>Bazuar në VKM-së nr. 879, datë 18.12.2019, <i>rekomandohet që te programet lëndore të shtohet një element në strukturë lidhur me Kodin e Etikës.</i></p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Vihet re se programet lëndore të Programit të Studimit janë rishikuar për të tre vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 dhe kjo përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit, pika 10, ku parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike dhe në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme. ⁵⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II. 4

⁵⁴ Rregullorja e programit të studimit, pikat 2 dhe 9. Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.

⁵⁵ Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës.

⁵⁶ Rregullorja e programit të studimit.

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se, programi i studimit Bsc në Arsim Parashkollor, përmban</p> <ul style="list-style-type: none"> - 180 Kredite, - 4500 orë në total sipas shpërndarjes më poshtë: -1798 orë në auditor; -2702 orë jashtë auditorit; <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.^{57,58}</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Konstatohet se shpërndarja e orëve të lëndëve dhe të praktikave mësimore në leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Shpërndarja përgjithësisht është bazuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar”. Raporti i orëve leksione/seminare, bazohet në natyrën e lëndës (nëse lëndët janë me natyrë teorike apo praktike), ndërsa sa i përket zhvillimit të lëndëve me zgjedhje, ato koordinohen në varësi të numrit të studentëve që i ndjekin.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Rezulton se programet lëndore janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, ku shumica e lëndëve bazë plus lëndët karakterizuese duhet të jetë 70% dhe ky kusht plotësohet, ndërsa përcaktohet raporti ndërmjet teorisë dhe praktikës, në kurrikulën e programit⁵⁹ si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 15% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë;

⁵⁷ Kurrikula e programit; Plani mësimor i programit.

⁵⁸ Plani mësimor i programit të studimit.ANEKS: Tabelat përmbledhëse-Tabela 13 “Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit”

⁵⁹ Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literatures, pika A.III.4.

	<ul style="list-style-type: none"> - 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë, në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; - 70% të programit e zënë analiza e thelluar dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës, në përputhje me informacionin e ciklit të tretë.
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Institucionit, rezulton se struktura e Programit të Studimit “Bachelor” në “Arsim Parashkollor”, organizimi i lëndëve dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, dhe raporti teori/praktikë është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, që është VKM nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca nr.1, Tabela nr.1, i ndryshuar. Nga takimet me stafin akademik, rezulton se stafi akademik bën përpjekje të konsiderueshme për të përditësuar syllabus-et me ato të zhvilluara në programe studimi të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se Programi i Studimit është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve të të nxënit, me qëllim përgatitjen e studentëve për t’u punësuar sipas profilit të programit. Nëse shikohet struktura e syllabuseve lëndore, vihet re se me kalimin nga viti në vit, kalohet nga aspektet teorike, në aspekte teorike-praktike dhe në fund drejt praktikës dhe aftësimin profesional të studentëve. Mund të thuhet se syllabuset e lëndëve janë ndërtuar në një mënyrë të tillë që mundësojnë transferimin apo mobilitetin⁶⁰ e studentëve sipas një procesi të arsyeshëm dhe pa arsye për stres.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Rezulton se Programi i studimit është zbatuar gjatë periudhës 2018-2021 dhe ka përjetur dy gjendje të jashtëzakonshme: atë të termetit dhe atë të pandemisë. Megjithatë, ashtu siç pranohet edhe në RVB, si edhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, <i>konstatohet që ka një mungesë të pjesshme të literaturës së detyruar në gjuhën shqipe.</i> Konstatohet se programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga Përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit.⁶¹ Institucioni ka mundësi të sigurojë literaturë bazë dhe e rekomanduar jo më të vjetër se 5 (pesë) viteve të fundit dhe të jenë të botuara nga pesë shtëpitë botuese më të</p>

⁶⁰ Plani mësimor i programit.

⁶¹ Dokumenti A.III .Pika 8.Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës.

	<p>njohura në botë si: Oxford, Pearson, Sage, Cambridge, McGraë-Hill, etj.⁶²</p> <p><i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit vihet re se përmbajtja e programit, synon që të pajisë studentët me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; formim qytetar të përgjithshëm; aftësi bazë për punë kërkimore; aftësi të përgjithshme praktike, aplikative etj, të përshtatshme për programet e studimit të ciklit të parë.⁶³</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Arsim Parashkollor", i ofruar nga UET, i korrespondon nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Sipas Shtojcës 1 të KSHK, përfundimi me sukses i këtij programi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Master i Shkencave - Master Profesional <p>ose, në mënyrë alternative, përfundimi me sukses i Programit të Studimit mundëson punësimin drejt profesionit të mësuesisë në arsimin parashkollor.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit⁶⁴ dhe bisedat me pedagogët e tij rezultojnë se realizohen dy herë në vit, mbledhje me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës për të marrë në konsideratë reflektimet e tyre lidhur me përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II. 5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

⁶² Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literatures.

⁶³ Rregullore e Programit të Studimit BA Arsim Parashkollor, pika 3.3.

⁶⁴ Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																														
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentave^{65, 66, 67, 68} të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim 15 pedagogë gjithsej nga të cilët 14 PAE dhe 1 PAK (93.3% / 63.7%).</p> <table border="1" data-bbox="675 465 1230 748"> <thead> <tr> <th><u>PAE</u></th> <th><u>PAK</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2 Prof.As</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>4 Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>8 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>14 PAE</td> <td>1 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim 10 pedagogë gjithsej nga të cilët 8 PAE dhe 2 PAK (80% / 20%).</p> <table border="1" data-bbox="675 887 1230 1169"> <thead> <tr> <th><u>PAE</u></th> <th><u>PAK</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3 Prof.Dr</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>3 Msc</td> <td>2 Msc</td> </tr> <tr> <td>8 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim 7 pedagogë gjithsej të gjithë PAE 100%.</p> <table border="1" data-bbox="675 1263 1230 1545"> <thead> <tr> <th><u>PAE</u></th> <th><u>PAK</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3 Prof.As</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2 Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2 Msc</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>7PAE</td> <td>0 PAK</td> </tr> </tbody> </table>	<u>PAE</u>	<u>PAK</u>	2 Prof.As	-	4 Dr.	-	8 Msc	1 Msc	14 PAE	1 PAK	<u>PAE</u>	<u>PAK</u>	3 Prof.Dr	-	2Dr.	-	3 Msc	2 Msc	8 PAE	2 PAK	<u>PAE</u>	<u>PAK</u>	3 Prof.As	-	2 Dr.	-	2 Msc	-	7PAE	0 PAK
<u>PAE</u>	<u>PAK</u>																														
2 Prof.As	-																														
4 Dr.	-																														
8 Msc	1 Msc																														
14 PAE	1 PAK																														
<u>PAE</u>	<u>PAK</u>																														
3 Prof.Dr	-																														
2Dr.	-																														
3 Msc	2 Msc																														
8 PAE	2 PAK																														
<u>PAE</u>	<u>PAK</u>																														
3 Prof.As	-																														
2 Dr.	-																														
2 Msc	-																														
7PAE	0 PAK																														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për</p>	<p>Rezulton se stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit, si titullarë të lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj konform kërkesave ligjore”.⁶⁹</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të PA:</p>																														

⁶⁵ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabelat 6.1_6.2_6.3_12.1_12.2_12.3; CV e stafit akademik të programit të studimit.

⁶⁶ ANEKS: Tabelat përmbledhës – Tabela 6.1; Tabela 12.1.

⁶⁷ ANEKS: Tabelat përmbledhës – Tabela 6.2; Tabela 12.2.

⁶⁸ ANEKS: Tabelat përmbledhës – Tabela 6.3; Tabela 12.3.

drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<ul style="list-style-type: none"> - Për 2018-2019, 66% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 34% janë Msc; - Për 2019-2020, 50% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 50% janë Msc; - Për 2020-2021, 72% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 28% janë Msc. 				
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Referuar RVB konstatojmë se stafi akademik i angazhuar për zhvillimin e lëndëve/moduleve është me grada e tituj, ose kualifikime të ciklit pasardhës (Msc.) dhe, bazuar në CV-të e tyre, ndarja e lëndëve është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të secilit të lidhura me specifikën e moduleve. ⁷⁰ Nga ana tjetër, stafi akademik, është i përfshirë edhe në projekte kërkimore, që janë në përputhje me programin e studimit dhe ekspertizën e tyre.				
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Konstatohet se për zhvillimin e praktikave profesionale, Departamenti bashkëpunon me Zyrën e Karrierës dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm për të garantuar akomodimin e studentëve në dhe mentorimin e tyre nga ekspertë të fushës në auditor. ⁷¹ Gjithashtu departamenti monitoron praktikat me anë të një pedagogu, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës. ⁷² Studentët që plotësojnë kriterin e mesatares kryejnë një punim diplome, për të përmbysur detyrimet e tyre ⁷³ , departamenti vë në dispozicion të studentëve, staf akademik të kualifikuar, për t'i udhëhequr gjatë realizimit të saj. ⁷⁴				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit, për shkak të specifikave të tij, rezulton se nuk parashikohen orë laboratorike, por në nivel fakulteti dhe institucioni ka zyrë përgjegjëse që merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve duke siguruar mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore.				
Shkalla e përmbushjes së	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%;">Nuk</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		

⁶⁹ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 12.1; 12.2; 12.3.

⁷⁰ Dokumenti G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore.

⁷¹ Marrëveshjet e bashkëpunimit.

⁷² Dokumenti B.I Mbi praktiken profesionale.

⁷³ Rregullore UET, Neni 39.

⁷⁴ Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III. 1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave të mëposhtme:</p> <p>Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS me përbërësit e tij, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS; - UET LMS Guide për pedagogun; - UET LMS Guide për studentet; - Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS; - Raport: ecuria e mësimi online; - Raportimet javore të mësimi online; <p>rezulton se UET ka hartuar dokumente instruktive që udhëzojnë pedagogët për mënyrën sesi duhet të hartojnë syllabuset, metodat e mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës, sistemit të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimit akademik dhe tutoriatit, frekuentimi, përdorimin e platformës LMS (Learning Management System), etj.⁷⁵ Nga ana tjetër gjatë mësimi online, prej pandemisë verëhet se është përdorur platforma TERAMs dhe LSM, si dhe evidentohet zhvillimi i mësimi dhe raportimit online. UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik, veçanërisht për asistent lektorët, të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies me në qendër të nxënët e studentëve.</p>

⁷⁵ Platforma LMS

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së UET, si dhe të formularëve të e vlerësimit që përdoren aty rezultojnë se kryhet monitorim sistematik i stafit nëpërmjet nëpërmjet metodave direkte dhe të tërthorta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës; - vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatën e tyre, vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; - vetëvlerësimi; - rezultatet e raporteve të KSBC-së; - vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori; - Zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara.⁷⁶ <p>Procesi i vlerësimit të mësimdhënies realizohet, në mënyrë periodike gjatë dhe në fund të semestrit.⁷⁷</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Rezultojnë se studentët përfshihen në vlerësimin periodik të mësimdhënies, të vlerësimit të tyre nga pedagogët me anë të formularit të vlerësimit të pedagogut, si dhe me anë të fokus-grupeve që organizohen nga Njësia e Cilësisë.⁷⁸ Institucioni organizon takime periodike në formën e “fokus grupeve” si dhe pyetësorë me frekuencë semestrale rreth problemeve specifike, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë, mbi format e metodave të mësimdhënies dhe çdo pedagog. Ankesat dhe sugjerimet e studentëve trajtohen nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, por dhe nga departamentit. Sa i përket ankesave individuale për vlerësimin e tij, studenti i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, mbështetur në nenin 32 të Rregullores së UET.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga bisedat me pedagogët rezultojnë se rezultatet e vlerësimit me anë të pyetësorëve bëhen publike në momentin e përshtatshëm për stafin pedagogjik, duke u siguruar në këtë mënyrë që këto rezultate të mos ndikojnë në objektivitetin e kryerjes së detyrës prej pedagogut. Të dhënat e vlerësimit përpunohen nga KSBC,</p>

⁷⁶ Rregullore e UET, Neni 22

⁷⁷ Formularë vlerësimi

⁷⁸ Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët

	apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve on-line i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET dhe Përgjegjësit të Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. <i>Rekomandohet që raporti i analizës së pyetësorëve të botohet edhe në faqen zyrtare të UET, ku mund të aksesohet me lehtësi si nga studentët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	GVJ është e mendimit se UET nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit identifikon praktikën e mira të vlerësuar prej studentëve dhe i promovon ato, nëpërmjet shpërndarjes së informacionit në burime të ndryshme nëpërmjet website të tij, nëpërmjet email-it tek stafi akademik etj. Gjithashtu për të promovuar përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se institucioni realizon trajnime të vazhdueshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III. 2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në Rregulloren e Departamentit ⁷⁹ identifikohen format e mësimdhënies janë: <ul style="list-style-type: none"> - leksionet - seminarët - praktikat profesionale - detyrat e kursit - provimet - mbrojtja e diplomës <p>Po në këtë rregullore jepet një pasqyrë më e detajuar e formave të mësimdhënies dhe konkretisht theksohet se veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet <i>mësimin në auditor</i> (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), <i>studimit individual</i> (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e punimit të diplomës/provim formimi)</p>

⁷⁹Rregullore e programit të studimit BA Arsim Parashkollor

	dhe <i>praktikës profesionale</i> . Nga bisedat me pedagogët rezulton se në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së edukimit, për të ndarë eksperiencat e tyre me studentët.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Nga bisedat me stafin mësimdhënës dhe me studentët konstatojmë se procesi mësimor zhvillohet duke u bazuar dhe tek nevojat e ndryshme të studentëve, p.sh në lëndën e matematikës, por dhe sipas llojit specifik të lëndëve të programit të studimit. Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Konstatohet se institucioni organizon “Development Day – Ditën e Zhvillimit të Stafit”, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë, dhe veprimtari me këtë fokus me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikatat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Duke shqyrtuar Manualin institucional të përdoruesit të sistemit UMIS, si dhe guidën për pedagogun; Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS dhe Raportin: Ecuria e mësimin online identifikohet se zhvillohen trajnime specifike për zhvillimin e kompetencës profesionale dhe për mësimin online gjate viteve të pandemisë. Në këto materiale, përfshihet një dokumentacion i plotë për mësimet online dhe vlerësimin e studentëve. Nga bisedat me personelin akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se këto metoda zotërohen dhe përdoren në mënyrë efektive nga personeli akademik.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Bazuar në CV-të e personelit akademik ⁸⁰ efektiv si edhe të atij me kontratë, rezulton se stafi akademike i përmbush kriteret ligjore dhe akademike të kualifikimit profesional. Anëtarët e stafit vijnë nga backgrounde të ndryshme arsimore, janë një kombinim i mirë brezash, si edhe një pjesë e tyre janë me formim tërësisht perëndimor. Nga bisedat me stafin konstatohet se ata përdorin metoda mësimore që kanë në qendër studentin. ⁸¹

⁸⁰CV e stafit akademik të programit të studimit

⁸¹Dosja e syllabuseve.

<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Rezulton se në përfundim të dy viteve akademike 2018-2019 dhe 2019-2020⁸² janë realizuar intervista të strukturuar përmes pyetësorëve të posaçëm, përmes të cilave është marrë mendimi i studentëve mbi format dhe metodat e mësimdhënies, nivelin e shpjegimit prej pedagogëve të koncepteve të reja, shkallën e komunikimit me studentët, shkallën e vlerësimit të dijeve të marra, nivelin e motivimit të pedagogëve, etj. Nga përfundimet e marra nga këta pyetësorë, rezulton se në përgjithësi studentët janë të kënaqur me nivelin e mësimdhënies, si edhe me metodat e mësimdhënies të përdorura.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Sipas bisedave me përfaqësues të studentëve, rezultoi se në orët mësimore të zhvilluara në kuadër të Programit të Studimit "Bachelor" në "Arsim Parashkollor" edhe sipas parashikimit në Rregulloren e Programit praktikohen forma të ndryshme të mësimdhënies interaktive si leksione (formale, të piketuara, provokative, etj), demonstrime, lojra, raste studimore, si edhe projekte të llojeve të ndryshme.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentit për ndërtimin e programit lëndor dhe të literaturës⁸³ konstatohet se stafi akademik nxit autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. GVJ është e mendimit se, format alterantive të mësimdhënies, metoda tradicionale të kombinuara me metoda inovative, që konstatohet se përdoren nga stafi akademik, krijojnë mundësi të udhëheqjes së studentit, angazhimit të tij, rritjes së iniciativës, mbështetjes së studentit për të përmbushur detyrimet lëndore, por edhe krijimit të respektit të ndërsjelle mes stafit akademik dhe studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Standardi III. 3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, konstaton se procesi mësimor i programit</p>

⁸²G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët; D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve; G-I-12-1 Formular i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik

⁸³ Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, pika A.III.4.1

<p>hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>BSc. në Arsim Parashkollor, realizohet në hapësira të mjaftueshme, cilësore, higjienike dhe që mirëmbahen rregullisht.⁸⁴</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se sallat e leksioneve dhe seminareve, ishin të pajisura me pajisjet hardware dhe software, me pajisjet audio-vizive si dhe kanë mbulim me internet, duke mundësuar kushte optimale për procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka nje ekip të IT për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, i cili është aktiv gjithnjë në mbështetje të problemeve që mund të ketë departamenti që mbulon programin. Të gjitha mjediset ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me internet. Studentët kanë mundësi në sistemin MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shpesh audio-vizive etj.⁸⁵</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se literatura për studim është e përcaktuar në secilin nga programet lëndore të programit të studimit dhe përdoren libra të botuara nga shtëpitë më të mëdha botuese dhe të botuara brenda 5 viteve të fundit. Kjo literaturë u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Biblioteka ka dhe tekste të azhurnuara të fushës e studimit në gjuhën shqipe, disa nga literaturat bazë ofrohen në gjuhën angleze. Po ashtu konstatohet se Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave dhe nga vëzhgimi në mjediset e bibliotekës së institucionit konsatohet se ajo është e pajisur me titujt dhe botimet kryesore për zhvillimin normal të programit të studimit dhe ato mund të përdoren pa problem nga studentët. Kjo bibliotekë është ka një numër të madh librash të botimeve të fundit, që i përkasin drejtimeve kryesore të programeve të studimit dhe furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Orari i Bibliotekës fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 09:00 - 17:00, kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur. Nga ana tjetër biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe</p>

⁸⁴ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42; Ref. Nr. 42.1)

⁸⁵ Të dhëna mbi platformën Learning Management System.

	që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. ⁸⁶
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Rezultoni se institucioni ka siguruar akses në disa librari on-line, si: Questia, Social Science Library, Sage, për personelin akademik dhe studentët. ⁸⁷ . Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS.Net, ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Konstatohet se institucioni ka në përdorim laboratorë mësimorë Informatike për këtë program studimi, të cilat janë të përshtatshme dhe të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive. Studentët kanë akses të vazhdueshëm në infrastrukturën kompjuterike për të realizuar detyra të ndryshme të tyre gjatë programit të studimit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Mjediset e institucionit janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi. Nga biseda me personelin akademik si edhe me përfaqësues të studentëve, rezultoni se në kushtet normale të jetës universitare, infrastruktura laboratorike shfrytëzohet mjaftueshëm prej studentëve, në varësi të zbatimit të planit mësimor.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Konstatohet se stafi akademik dhe studentët përdorin sistemin MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj, si dhe ka mundësi të shikojë notat nga kudo që ndodhet ⁸⁹ . Vihet re se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platformën online UET LMS dhe Microsoft Teams. Sipas Urdhrit administrativ për LMS, nr.09, datë 02/11/2017 “Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS” ⁸⁸ urdhërohet vendosja në efikasitet të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, ëbllink-e me material shtesë, hedh notat e vlerësimit për studentët e tij. ⁸⁹ Platformat online të mësimdhënies (e-learning), UET LMS dhe Microsoft Teams, konstatohet se u përdorën masivisht gjatë semestrit të dytë të

⁸⁶ Infrastruktura në dispozicion të programit; Inventari i teksteve në fushën e programit.

⁸⁷ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela Nr. 17: Të dhëna të plota për platformat online/struktura e IT/Biblioteka

⁸⁸ Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS.

⁸⁹ Të dhëna për platformën LMS.

	vitet akademik 2019-2020, në kushtet e pandemisë, Covid-19. ⁹⁰ për të cilën janë kryer dhe trajnime nga Zyra e IT në UET për zhvillimin e procesit mësimor në platformat online Microsoft Teams dhe LMS. ⁹¹			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sic thuhet më sipër sistemi i komunikimit të brendshëm, online konstatohet se është i aksesueshëm për personelin akademik dhe studentët për të përdorur dokumentacionin elektronik. Po ashtu është funksional dhe Intraneti (<i>Dokumenta UET</i>) për programet e lëndëve dhe dokumentacionin që lidhet dhe me zbatimin e këtij programi studimi. Nëpërmjet UET LMS pedagogët dhe studentët shkëmbejnë materiale, njoftime dhe çdo informacion që lidhet me lëndët dhe arritjet e tyre.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Rezulton se institucioni ka dokumente zyrtare për procedurat e mbrojtjes së diplomimit me temë diplome, procedura që janë të zyrtarizuara që nga momenti kur studenti bën aplikimin për temë diplome deri në mbrojtjen e saj ⁹² , kurse Departamenti vë në dispozicion ekspertizën e personelit akademik, me drejtimet ku ata mund të udhëheqin tema.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III. 4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së	Rezulton se Institucioni e menaxhon procesin e përmirësimit të cilësisë me anë të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një organizëm i pavarur. Ky organizëm vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. ⁹³ Nga ana tjetër ky komision bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të

⁹⁰ Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19.

⁹¹ Video-trajnime mb sistemin TEAMS/LMS; Raport: ecuria e mësimin online.

⁹² Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës.

⁹³ Statuti i UET, Neni 16

mësimdhënies.	parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. ⁹⁴
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Nga takimi me strukturat drejtuese si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, GVJ është e mendimit se njësia bazë mbështet dhe nxit proceset të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit. Institucioni rezulton të ketë një politikë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe strukturat demonstrojnë kryerjen e aktiviteteve në vënien në zbatim të kësaj politike, siç janë trajnimet e zhvilluara, ku stafi i programit merr pjesë. ⁹⁵
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga bisedat me pedagogët, si edhe me studentët, u konstatua se në situatën e pandemisë në vitin 2020-2021, në dispozicion të të gjithë stafit akademik janë shpërndarë manuale të mësimin online, si edhe janë zhvilluar trajnime të stafit lidhur me metodat e reja të mësimdhënies. Nga ana tjetër konstatohet se eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies inkurajohet në kuadrin e departamentit, ngaqë personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja, inovative në procesin e mësimdhënies. Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë për çdo temë metoda pedagogjike që do të përdoret në mësimdhënie. ⁹⁶
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga takimet me stafin e programit, rezulton se institucioni mbështet stafin në kualifikimin e vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor, duke i shërbyer kështu ngritjes shkencore të stafit, objektivave akademike të tyre dhe që reflektohen edhe në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Duke iu referuar informacionit në DVV dhe atij të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë disa trajnime të kryera për këtë qëllim. <i>Qendra e Metodologjisë dhe Kërkimit</i> ofron trajnime 1-ditore ose me gjatë për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike. ⁹⁷
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë	Si dhe më sipër evidentohet se institucioni zhvillon trajnime të personelit akademik për çështje didaktike dhe të metodave.

⁹⁴ Plani veprimit KSBC

⁹⁵ Dokumenti F.V. Për organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit.

⁹⁶ Formatimi për hartimin e silabusit.

⁹⁷ Strategjia e kërkimit shkencor në UET 2017-2020; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025, pikat 1.2, 3.4, 6 dhe 12.

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Ndërkohë stafi akademik ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave të reja, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1; - Trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera).⁹⁸ 			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Konstatohet nga shqyrtimi i Rregullores së programit se stafi akademik është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e mësimdhënies, ku që në hartimin e silabuseve identifikohen metodat e mësimdhënies për secilën temë dhe konsierohet nga bisedat me stafin se përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale pedagogut. Nga ana tjetër, në kushtet e krijuara nga situata pandemike Covid-19, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, pa përjashtim i gjithë stafi akademik u angazhua në mësimdhënie online në platformat e-learning, për të cilat u trajnua.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Kushtet jashtëzakonisht specifike të viteve 2019-2021, për shkak të tërmetit dhe pandemisë së Covid-19, kanë kufizuar veprimtarinë normale të instituconit si kudo tjetër. Por vihet re se stafi ka motivim të testojë metoda të reja mësimdhënieje, si dhe të analizojë efektet e tyre për të nxënë. Stafi akademik gëzon lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie dhe ka mundësi e hapësirë që të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme. Kur konsiderojnë një eksperiencë të re, efektive, raportojnë në takimet e punës me kolegët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III. 5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të	Konstatohet se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të

⁹⁸ Plani Strategjik për zhvillimin e programit, Prioritetet në trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik; Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS.

njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në Rregulloren e programit. ⁹⁹ Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Nga ana tjetër studenti informohet për këtë gjë dhe nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik, gjatë seancës së parë të semestrit, prezanton syllabusin, temat, literaturën, metodologjinë e vlerësimit gjithësemestral. GVJ e gjykon një praktikë të mirë marrjen e feedback nga studentët, mbas prezantimit të syllabusit prej pedagogëve të lëndës, për të rritur reagueshmërinë si dhe angazhimin e tyre gjatë semestrit. ¹⁰⁰			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Siç përmendet në Kriterin 1 të standardit III.5, në Rregulloren e Programit saktësohen se kontrolli dhe vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në forma të larmishme, si me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me qëllim që pedagogu i secilës lëndë të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënit. ¹⁰¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III. 6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Nga shqyrtimi i rregulloreve të UET dhe të Programit, si dhe nga bisedat me pedagogë, rezultojnë se vlerësimi i studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të provimit të ndërmjetëm; përfshirjes aktive në

⁹⁹ Rregullorja e programit të studimit (Ref. Nr. 7); Dokumenti A.IV. Për sistemin e vlerësimit të studentëve

¹⁰⁰ Silabusete lëndëve (Ref. Nr. 19)

¹⁰¹ Dokumenti A.IV. Për sistemin e vlerësimit të studentëve

	seminare; detyrat e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike); provimit përfundimtar ¹⁰² , kurse nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës. ¹⁰³
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Rezulton se mëpërmjet UET LMS pedagogët dhe studentët shkëmbejnë materiale, njoftime por dhe notat për lëndët dhe arrijtjet e tyre gjë që i bën dhe transparente proceset e vlerësimit. Referuar RVB institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) po instalon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, kjo në varësi të numrit të studentëve, për të shmangur sjelljet joetike nga ana e studentëve. ¹⁰⁴ Në rast ankesash studenti mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. ¹⁰⁵
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Sipas evidencës “Sistemi i vlerësimit të studentëve” rezulton se provimet e studentëve sekretohen ku ekziston infrastruktura e nevojshme, njerëzore, sepse secila sallë e provimeve ka personel monitorues. Konstatohet se provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. ¹⁰⁶ Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit. ¹⁰⁷
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse	Sipas evidencës “Sistemi i vlerësimit të studentëve” konstatohet vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta

¹⁰² Rregullorja e programit të studimit, pika 5.2

¹⁰³ Rregullore UET, Neni 24

¹⁰⁴ Rregullore mësimore e programit të studimit BA Arsim Parashkollor, pika 5.3.3. Rregullore UET, neni 27, pika 4.

¹⁰⁵ Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8

¹⁰⁶ Rregullorja e programit të studimit, pika 5.3; Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.1.8.6

¹⁰⁷ Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6.e.

<p>është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Referuar RVB në tezat e provimeve është seksioni “<i>Komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit për pyetjen e kategorisë C “Mbah qëndrimin tënd”</i>” ku pedagogu jep feedback mbi zhvillimin e pyetjes nga studentit.¹⁰⁸</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Refruar RVB konstatohet se institucioni përdor sistemin antiplagjiaturë (<i>Turnitin Ephorus</i>), në mënyrë që punimet e studentëve të mund të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas për plagjiaturë përpara se të marrin vlerësimin final nga pedagogët, apo komisionet e vlerësimit përkatës. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohen me marrjen e notës mbetëse 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.¹⁰⁹ Nga ana tjetër, nga bisedat me stafin e programit, konstatohet se gjatë zhvillimit të provimeve, provimi /salla ku zhvillohet testimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë të caktuar me miratim nga Departamenti, të cilët janë njëloj përgjegjës për ecurinë e provimit në sallë.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së Institucionit rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit (vendosen pikët për secilën pyetje dhe më pas mbledhen), e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë.¹¹⁰ Rregullorja saktëson se pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre, pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së Institucionit respektohen të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe kërkesa për rishikimin e tij është të garantuara. Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (<i>LMS dhe UMIS</i>). Brenda dy javëve nga realizimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin¹¹¹.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë,</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit ankimmimet e</p>

¹⁰⁸ Format i tezës së provimit përfundimtar

¹⁰⁹ Rregullore UET, Neni 33.

¹¹⁰ Rregullore e UET, neni 27.

¹¹¹ Rregullorja mësimore e Programit të Studimit BA Arsim Parashkollor, pika 5.3.4,

ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	studentëve shqyrtohen nga një komision vlerësimi që ngrihet në department, duke përfshirë pedagogë kompetentë për të gjykuar çështjen. Procedura zhvillohet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. ¹¹²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III. 7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Siç është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ, por konstatohet në RVB dhe në Rregulloren e Programit të Studimit ¹¹³ se Programi i studimit Bachelor në “Arsim Parashkollor”, synon ta pajisë studentin me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së Mësuesisë në Arsim Parashkollor, si dhe ndërthur njohuritë teorike dhe elementet praktikë për të zhvilluar aftësitë e studentëve për të punuar në fushën e arsimit parashkollor. Vështrimi teorik ndalet mbi fushat bazë të shkencave të edukimit, si zhvillimi i individit, fushat e zhvillimit të personalitetit, aspektet e personalitetit në zhvillim të individit, problematikat kognitive e sociale, ndërsa aspektet praktike fokusohen mbi vlerësimin e çdo individi në treguesit standardë të zhvillimit të gjithë fushave. Të kombinuara së bashku këto dimensione e pajisin studentin në Bachelor me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi elementare në lidhje me punën si mësues i edukimit parashkollor.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit rezulton se Programi i studimit, synon të formojë edhe qytetarin, krahas ofrimit të njohurive në fushën përkatëse të mësuesisë. Në kurrikul janë përfshirë edhe lëndë që e ndihmojnë të zgjerojë njohuritë në fushat humane dhe sociale, përmes lëndëve të Kategorisë A si “Hyrje në filozofi”, “Hyrje në Sociologji”, “Hyrje në ekonomi”, të përmirësojë aftësitë në fushën e

¹¹² Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8,

¹¹³ Rregullore e programit, Aneksi I; Monitorimi dhe ecuria e studentëve, diplomimi dhe punësimi – Edukim,

	<p>teknologjisë së informacionit, dhe gjuhës së huaj përmes ndjekjes së lëndëve “Bazat e Informatikës” dhe “Anglisht” në kategorinë D. Nga ana tjetër për të zhvilluar aftësitë e komunikimit janë të përfshira lënda të tilla si “Teoritë e komunikimit pamor”, “Komunikim ndërkulturor”, “Puna individuale dhe në grup” etj.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët në fund të çdo lënde, për Programin e Studimit "Bachelor" në “Arsim Parashkollor” tregohen kryesisht me rezultatet e arritura prej studentëve përmes formave të ndryshme të vazhdueshme të testimit, si edhe përmes arritjeve në provimin përfundimtar. Analiza më të hollësishme, për rezultatet që arrijnë studentët në fund të çdo viti akademik, bëhen në raportet vjetore të Departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Rezulton se kurrikula në përgjithësi dhe syllabuset në veçanti, për të gjitha lëndët e Programit të Studimit BA në “Arsim Parashkollor” janë rishikuar në atë masë që lejon ligji, në përgjigje të problematikave që kanë dalë gjatë zbatimit të tyre. Nga bisedat me stafin vihet re se studentët orientohen para testeve të pjesshme dhe përfundimtare, në mënyrë që të fokusohen te çështjet më të rëndësishme të lëndës. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të cilat do tu nevojiten studentëve. Gjithashtu, pedagogu sipas mundësive të tij, është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për shkak se Programi i Studimit "Bachelor" në “Arsim Parashkollor” e ka zanafillën në vitin akademik 2018-2019, si edhe për shkak të pengesave dhe problematikave ligjore të krijuara nga situata pandemike, nuk ka qënë e mundur realizimi i orëve të hapura apo seminareve të zgjeruara me prani fizike, por theksojmë se në institucion zhvillohen vazhdimisht leksione të hapura, nga pedagogë të institucionet ose ekspertë e personalitete të ftuar, për çështje të aktualitetit dhe zhvillimeve të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë.¹¹⁴</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në</p>	<p>Konstatohet se stafi akademik, i angazhuar në këtë program studimi, i ka hartuar syllabuset¹¹⁵ lëndore duke mbajtur parasysh nivelin e zhvillimit të kompetencave që duhet të zotërojë nxënësi në arsimin parashkollor, duke respektuar</p>

¹¹⁴ Kalendar i aktiviteteve.

¹¹⁵ Silabuset e lëndëve.

laboratorë dhe praktikat profesionale.	karakteristikat e zhvillimit moshor dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga shqyrtimi i RVB-së së UET, por edhe nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se një nga elementët kryesorë të procesit mësimor në institucion është diskutimi dhe puna në grup për interpretimin apo zgjidhjen e çështjeve të caktuara, shkëmbimit të përvojave të ndërsjellta, si edhe fokusimi mbi çështje jetësore.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga shqyrtimi i RVB-së së UET, por edhe nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se puna në grup dhe diskutimet konsiderohen të rëndësishme për arritjen e objektivave mësimore. Nisur nga sa më sipër, personeli akademik mbështet dinamikën e punës në grup për zgjidhjen e problematikave të caktuara. Gjithashtu, për detyrat e kursit që studentët mund të prezantojnë gjatë orëve të seminarit, pedagogët lejojnë që studentët ta zhvillojnë atë në grupe prej 2-3 vetash, në bazë të temave të përcaktuara më parë. Në këtë mënyrë zhvillohen dhe aftësitë e studentëve për të punuar në grup.
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Siç edhe shkruhet në RVB e paraqitur nga UET, por edhe nga bisedat me stafin akademik dhe përfaqësues të studentëve, rezulton se Institucioni ka mbështetur në mënyrë modeste financiarisht personelin akademik për promovimin e tyre profesional, ndërsa mbështetja e studentëve gjykohet sipas rastit. Institucioni ka streteji kërkimore-shkencore të publikuar në intranet dhe stafi nxitet e që të bëhet pjesë e projekteve, të publikojë në revista shkencore me faktor impakti, por i kërkohet stafit akademik të inkurajojë përfshirjen e studentëve, në punën kërkimore shkencore lidhur me fushën e tyre të formimit profesional
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Siç edhe shkruhet në RVB e paraqitur nga UET, shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore zhvillohen kryesisht në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, të cilat mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, kurse mobiliteti i studentëve dhe përshtatja e tyre me mjedisin e institucioneve pritëse bëhet me e lehtë, pasi ata hasin praktika të ngjashme me çfarë kanë përjetuar gjatë studimeve në UET. Nga ky program studimi nuk rezulton ndonjë studnet që të ketë patur shkëmbime studnetore për shkak të numrit të ulët të studentëve të regjistruar në program dhe mungesës së interesit.
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III. 8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar evidencës “Mbi punimin e diplomës” ¹¹⁶ konstatohet se institucioni zbaton një procedurë të posaçme për studentët të cilët mbrojnë diplomën, e cila mbrohet pas paraqitjes së një punimi diplome, i cili mund të jetë: (i) <i>temë diplome, për programet Bachelor</i> , me kërkesë të studentit, për studentët me notë mesatare së paku 8.5, por dhe nëpërmjet dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtar.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Institucioni dhe stafi akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. Të gjitha procedurat janë të parashikuara në Rregulloren e UET, si dhe në dok sistemi i vlerësimit të studentëve. ^{117,118} . Zbatimi i tyre nxitet dhe monitorohet nga pedagogët udhëheqës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga shqyrtimi i evidencës për sistemin e vlerësimit të studentit rezulton se përmbajtja e programit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar bazohet në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë: <ul style="list-style-type: none"> - 20% lëndë nga Kategoria A; - 70% lëndë nga Kategoria B; - 10% lëndë nga Kategoria C; Referuar RVB, nga viti akademik 2019-2020 pesha do të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C ¹¹⁹ . Komisioni i Posaçëm për administrimin e provimit final përbëhet nga 5 anëtarë që janë pedagogë të fushave kryesore të programit të studimit. Teza e provimit hartohet në bashkëpunim midis tyre duke u kujdesur që të përmbajë pyetje thelbësore nga të gjitha lëndët/modulet e zhvilluara përgjatë tre viteve të studimit. Teza e provimit, sikurse u theksua edhe

¹¹⁶ Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës.

¹¹⁷ Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.3.

¹¹⁸ Rregullore UET, neni 39 pika 2.

¹¹⁹ Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.3.

	më sipër, hartohet në bazë të <i>bankës</i> së pyetjeve, e cila u bëhet e njohur paraprakisht studentëve. Ndërsa vlerësimi i temës së diplomës bëhet përmes përdorimit të sistemit me pikë, i cili vlerëson me anë të pikëzimit elementët kryesorë të temës së paraqitur nga studenti.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Referuar takimit me studentët e programit të studimit, si dhe me stafin e programit, rezulton se supervizorët akademikë që udhëheqin studentët në diplomë, orientojnë, udhëzojnë, kontrollojnë studentët gjatë punës përgatitore për projektin e diplomës. Sipas evidencës “Për punimin e diplomës” ai që është Pedagogu udhëheqës ka për detyrë që të zhvillojë seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, jo vetëm për të përcaktuar temën, por edhe për t’i ndihmuar përballimin e vështirësive gjatë zhvillimit të tezës së diplomës deri në dorëzimin e saj. ¹²⁰
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë shqyrtimit të evidencës “Për punimin e diplomës” si dhe nga diskutimet me pedagogë dhe studentë të programit konstatohet se për studentët e ciklit BA, punimi i diplomës mund të ketë karakter teorik ose empirik. ¹²¹ Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, punën në terren, planifikimin, zhvillimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. ¹²²
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Konstatohet se procesi i hartimit të temës së diplomës lehtësohet nga pedagogu udhëheqës. Në evidencën përkatëse “Mbi punimin e diplomës” përcaktohet se seancat metodologjike, duhet të trajtojnë çështje të tilla, si: Trajtimi i aspekteve metodologjike; përpunimi i metodave të paraqitjes sasiore; puna në terren, planifikimi, zhvillimi dhe raportimin e gjetjeve/të dhënave. Sa i takon finalizimit të punimit të diplomës, ¹²³ pedagogu udhëheqës garanton cilësinë e rezultateve të punimit, sepse studentët nuk mund të dorëzojnë punimin e diplomës, pa marrë miratimin e udhëheqësit. ¹²⁴
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Konstatohet se, sipas Rregullores së Programit dhe të institucionit, provimi përfundimtar ose punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e thjeshtë e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në

¹²⁰ Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës, pika B.II.5.2.

¹²¹ Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës, pika B.II.6.

¹²² Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës, pika B.II.5.2.

¹²³ Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës, pika B.II.5.2.

¹²⁴ Rregullore UET, neni 39, pika 3.

	fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Referuar DVV dhe evidencave përkatëse të cituara në vijim, rezulton se në përfundim të programit të studimit, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR. Kohëzgjatja e lëshimit të diplomës është brenda 6 (gjashtë) muajve.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas evidencës” Modeli i diplomës dhe Modeli i suplementit” konstatohet se, në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion, kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Sekretaria mësimore e pajis studentin me <i>Suplementin e Diplomës</i> , ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur në gjuhët shqip dhe anglisht. ¹²⁵			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Pas mbarimit të studimeve dhe pajisjes me diplomë, dokumentacioni i studentëve, rezulton të ruhet në Zyrën e Sekretarisë, dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbledh,	Nga vizita e kryer në UET, nga takimi dhe biseda e zhvilluar

¹²⁵Modeli i diplomës dhe Modeli i suplementit për secilin nga profilet.

<p>ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>me drejtuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore konstatuam se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik. I gjithë dokumentacioni ruhej dhe depozitohej nga Zyra e Burimeve Njerëzore¹²⁶, e cila kujdesej si për Stafin Akademik me kohë të plotë ashtu edhe atë me kohë të pjesshme¹²⁷. Ne patëm mundësi të shikonim disa nga dosjet e personelit dhe vume re që Zyra e Burimeve Njerëzore mbante evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>U evidentua se UET-i ka procedura të qarta dhe transparente lidhur me mënyrën e rekrutimit të stafit. Gjithçka lidhur me këto procedura janë të përcaktuara në aktet rregullatore të funksionimit të institucionit, në procedurat, kriteret për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.¹²⁸</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>U konstatua se mbi bazën e nevojave të Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve (DPES), bëhej kërkesa e argumentuar për staf të ri akademik të brendshëm apo të jashtëm. Ky propozim i paraqitej Dekanatit dhe pasi miratohej i jepej Zyrës së Burimeve Njerëzore duke ndjekur të gjitha fazat dhe procedurat e rekrutimit të stafit konform rregullores. Mbi bazën e vendit vakant të punës, bëhej edhe ndërtimi i kriterëve të veçanta sipas funksionit që kërkohej të mbulohej. Kriteret shpallehin publikisht dhe përzgjedhja e kandidatëve konkurues bëhej me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëheshin në faqjen zyrtare të universitetit¹²⁹, në rrjetet sociale¹³⁰ dhe në gazetën Liberale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit</p>	<p>Vlerësimi i stafit akademik zhvillohej si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura ishin të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit¹³¹. Përzgjedhja e personelit të ri bëhej duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore. Komisioni i Rekrutimit përbëhej nga 7</p>

¹²⁶ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁷ Format Dosje Stafi Akademik.Parë në Prill 2022,gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁸ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁹ Faqja zyrtare e UET <https://uet.edu.al/rreth-uet/>

¹³⁰ Shembull thirrje për staf akademik. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³¹ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 22.Dokument G. Rregullore për Burimet Njerëzore.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	anëtarë: <ul style="list-style-type: none"> - Administratori i “EEI” SHPK; - Rektori, Zv. Rektori, Prorektori; - Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore; - Drejtuesi i Departamentit (DPES) dhe sipas rastit; - pedagogë apo ekspertë të fushës jashtë UET-it; Pas vlerësimit më pikë të intervistës së secilit kandidat nga secili anëtar i Komisionit të Rekrutimit, kandidatët me më shumë pikë mund të mbanin leksion të hapur para DPES. Pas shpalljes, kandidati fitues pajisej me kontratë pune, kohëzgjatja e së cilës përcaktohet sipas Statutit të UET-it. ¹³²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që infrastruktura e UET krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka zyra të veçanta dhe po ashtu edhe zyra mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, salla interneti, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, Sekretaria mësimore, etj. janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre. ¹³³
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e	Nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve (DPES) gjatë vizitës në UET, u evidentua interesi dhe angazhimi maksimal i institucionit për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. Sipas anatarëve të DPES,

¹³² Statuti UET (Ref. Nr. 3). Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³³ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studimit.	<p>kualifikimi i stafit dhe fitimi i gradave dhe titujve ishte ndër prioritetet kryesore të institucionit. UET-i mbështeste zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë bazë (Ditët e Studimeve Shqiptare) dhe në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera jashtë vendit (kryesisht Europë)¹³⁴, mundësonte që pedagogët e tij të zhvillonin disa orë mësimi në auditoret e këtyre universiteteve (në kuadër të Shkëmbimeve Erasmus +). Angazhimi serioz i institucionit për kualifikimin e stafit të tij, u konstatua nga fakti që UET-i kishte ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor për stafin që botonte artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters. Nisma më e fundit e tij ishte krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisciplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve u ishte akorduar një fond i caktuar vjetor për kërkim shkencor.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.</p>	<p>Nga evidencat e RVB-së për këtë program studimi si dhe nga bisedat e bëra në institucion me drejtuesin e Zyrës së TIK, u evidentua se institucioni ka zhvilluar seanca të tëra trajnimesh të stafit lidhur me përdorimin e platformave të reja teknologjike. Nga Zyra e TIK janë kryer trajnime për përdorimin e sistemit UET LMS dhe Microsoft TEAM për pedagogët, në kuadër të mësimit online, të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij.¹³⁵</p> <p>Po ashtu, në bashkëpunim me <i>Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit</i>¹³⁶ janë ofruar trajnime 1-ditore ose më të gjata për zhvillimin profesional të stafit akademik në lidhje me aftësimin e tyre për punë kërkimore të pavarur që të jenë të botueshme në revista shkencore me faktor impakti.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Evidentohet se DPES planifikon kohën vjetore të punës sipas nevojave për realizimin e procesit mësimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të dorëzuara për ngarkesën totale të personelit akademik për këtë program studimi për vitin 2020-2021, GVJ konstatoi që janë angazhuar 7 personel akademik, të gjithë efektiv.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

¹³⁴ Projektet YET 2014 – 2020; <https://uet.edu.al/inter-institutional-agreement/>. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁵ Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁶ Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020; 2021-2022. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita e zhvilluar në UET (në kampusin e ri universitar: Rruga “Xhanfize Keko”, Nd. 56, Tiranë) konstatohet se mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Sipas evidencave të paraqitura nga institucioni, DPES që është pjesë integrale e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, ka zhvilluar programin BA Arsim Parashkollor (2018-2021) në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H.1, Godina B. Sipas evidencave të ofruara nga UET, kjo godinë me sip. rreth 500 m ² ka ofruar mjedise të përshtatshme dhe laboratorë në funksion të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe të programit të studimit Ba Arsim Parashkollor. ¹³⁷
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konfirmoi në vizitën e tij në institucion që auditorët ishin të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme (tabela, videoprojektor dhe PC) për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit. Platforma UET LMS u mundësonte studentëve që të azhurnoheshin në kohë reale me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, kuize, detyra kursi, materiale shtesë audio vizive, etj. ¹³⁸
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve,	Nga vizita e zhvilluar në institucion, sallat e leksioneve, laboratorët dhe biblioteka ishin të gjitha të pajisura me mjete teknologjike. Në veçanti, sallat e leksioneve dhe të seminareve kishin mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi ishte edhe biblioteka e UET me sip. rreth 300 m ² dhe

¹³⁷ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


¹³⁸ Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; UET-LMS Guidë për pedagogun; UET_LMS Guidë për studentët.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	me 150 vende leximi. Laboratorë të tjerë mësimor ishin nëntë. ¹³⁹ Në sallat e pajisura me mjete audio vizive u mundësohej studentëve të BA Arsim Parashkollor paraqitja e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucionin konfirmoi që IAL ka shtatë laboratorë të pajisur mirë të teknologjisë së informacionit të cilat janë të pajisura me programet të nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektiv. Laboratorët mund të përdoren nga studentët për të përgatitur detyrat dhe punimet e tyre të diplomës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Evidentuar gjatë vizitës në institucion se UET ka infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të një pjese të veprimtarive praktike në institucion. Ky universitet kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme për plotësimin e gjithë kriterëve që duhen për nevojat e programeve të studimit. Në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve të programit të studimit Ba Arsim Parashkollor, ky institucion kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës dhe me Kopshtin “Lulet e jetës”. ¹⁴⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi IV. 4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Institucioni disponon një bibliotekë, me sipërfaqe 35 m ² në godinën A. Këto mjedise mund të shfrytëzohen nga studentët e këtij programi studimi. Studentët mund të përdornin për nevojat e tyre si literaturën fizike ashtu edhe atë elektronike

¹³⁹ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁰ Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale.Aneks Tabela 5; Marrëveshjet e bashkëpunimit.Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

barabartë nga studentët e programit të studimit.	të ofruar nga biblioteka e UET.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Rezultoi si biblioteka kishte një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra dhe tekste mësimore, periodikë, CD dhe harta, në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Literatura fizike në bibliotekë, pasurohej vit pas viti. Staf i akademik parashtronte kërkesën për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësimit të formatit përkatës ¹⁴¹ . Funkciononin edhe libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia ¹⁴² ku kishin tituj në gjuhë të huaj.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Mundësitë që kishte krijuar ky institucion përmes abonimit në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitetet infrastrukurore në bibliotekë (PC, Wi-Fi) garantonin aksesin pa pagesë të studentëve në këto biblioteka.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Aktualisht biblioteka ka pajisje elektronike dhe akses në internet, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. Fondi i bibliotekës është i gjithi digjitalizuar dhe studentët mund ta konsultojnë atë online. Biblioteka e UET duke qenë pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), ajo ofron mundësi shumë të larta aksesimi për studentët e saj.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Pasurimi i fondit të bibliotekës ishte një proces i vazhdueshëm dhe objektiv i rëndësishëm i institucionit. Nga bisedat e zhvilluara me Përgjegjësin e programit, ai pohoi se çdo përgjegjës programi hartonte një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve dhe mbi bazën e nevojave të departamentit. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, ishin të përcaktuara në dokumentet që rregullonin veprimtarinë e Institucionit ¹⁴³ .
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që orari i bibliotekës është çdo ditë të javës: nga e Hënë-Premte 9:00-

¹⁴¹ Dokumenti E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë; Inventari i teksteve në fushën e programit; Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës_Infrastruktura; Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴² ANEKS: Tabela Nr. 17: Të dhëna për platformat on-line/strukturat IT/Biblioteka. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴³ E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë; Dokumenti E. IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës; shembull procedure_blerje literature.Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve ajo ishte e hapur me orar të zgjatur duke u dhënë mundësi studentëve të siguronin literaturën e tyre pothuajse në çdo kohë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV. 5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>UET përdorte sistemin UMIS¹⁴⁴ nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit. Ndërfaqja e studentëve jep të gjitha detajet në lidhje me kurset e marra nga studentët, notat, frekuentimin, financat, informacione brenda kampusit, informacione personale të studentëve. Një nga funksionet kryesore të UMIS ishte: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmbante informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi MOODLE (UET LMS) bënte të mundur që studenti në kohë reale të kishte akses në materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shpesh audio vizive, gjithashtu i siguron personelit akademik disa funksionalitete për të ndjekur dhe menaxhuar rezultatet akademike të studentëve, frekuentimin dhe gjithashtu disa funksione të përgjithshme që i përkasin statusit të stafit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që ky sistem menaxhon të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik dhe administrativ në mënyrë hierarkike. Ai është një sistem</p>

^{144/148} Manual i përdoruesit të sistemit UMIS. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	funksional dhe një instrument efektiv për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit.. ¹⁴⁵			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET LMS (Learning Management System) siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sistemi u mundësonte pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorim të sistemit nga studentët. Nëpërmjet UET LMS, bëheshin edhe lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	UET ka sistemin e menaxhimit të mësidhënies UET LMS, i cili lehtëson komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studenteve në kohë reale. Sistemi bazohet në Moodle, mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve në internet. Studentët dhe instruktorët mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit LMS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuara sipas roleve dhe njësive përkatëse. Staf i akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e internetit të UET paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentët në anglisht. Gjithashtu përdoren edhe rrjetet sociale si Facebook, Instagram të cilat shërbejnë, si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në institucion. UET kishte ndërtuar faqen e re në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Informacionet që shfaqeshin në faqen zyrtare të UET, ishin të përcaktuara edhe në dokumentet e këtij institucioni. ¹⁴⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁴⁶ Dokumenti pika E.V. Mbi politikat e prezantimit/promovimit të UET *on – line*. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Standardi IV. 6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton një Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar për UET. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Raporti hartohet në bazë institucioni dhe nuk ishin të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. ¹⁴⁷
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	U konstatua nga vizita në institucion dhe nga evidencat e paraqitura se Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. ¹⁴⁸ Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohej në programe të ndryshme ishte praktikisht e pamundur të hartoheshin raporte në bazë të programeve të studimit. <i>Rekomandohet që të hartohet plan dhe raport financiar për programin e studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të	Referuar RVB, UET kryente auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. ¹⁴⁹ Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të

¹⁴⁷ Pasqyrat financiare me shënime; Raportet e auditimit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁸ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 18.1: Të dhëna mbi koston për student; Tabela 18.2: Të ardhura dhe financime të ndryshme. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁹ Raportet e auditimit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	shoqërisë deri në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. ¹⁵⁰			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Evidentuam se UET ka raport auditiv çdo vit. Sipas Raporteve financiare, ato përmbanin transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët. Raportet financiare jo vetëm pasqyrojnë të gjitha zërat e buxhetit për një vit (deri me 31 dhjetor të çdo viti), por bëjnë edhe një analizë krahasuese me vitet paraardhëse.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Referuar RVB të dhënat financiare të institucionit garantonin aftësinë e tij për një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmonin kapacitetet e institucionit për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V. 1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e

¹⁵⁰ Pasqyrat financiare me shënime. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rezultoni se procesi i procedurave për kriteret e pranimit të studentëve, transferimit dhe deri në dalje të tyre, mbështetet në: legjislacionin në fuqi: Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019, Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”; në statutin dhe rregulloret përkatëse të UET¹⁵¹, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukture të institucionit. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online.¹⁵², në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të institucionit dhe me studentët e diplomuar të programit të studimit u konstatua se kriteret dhe procedurat nga hyrja deri në dalje e studentëve ishin transparente për të gjithë dhe garantoni barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit.¹⁵³</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme</p>	<p>Bazuar në takimin e zhvilluar gjatë vizitës në institucion me studentët e diplomuar në këtë program studimi, rezultoi se kriteret dhe procedurat për pranimin, transferimin e tyre dhe njohjes së studimeve të mëparshme, ishin të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të gjithë dhe përveç kësaj, gjithçka u bëhej e ditur atyre nga stafi i UET gjatë vizitës së tyre në institucion.¹⁵⁴ Ne konstatuam se kriteret dhe procedurat ishin të aksesueshme online, po ashtu edhe aktet rregullatore u</p>

¹⁵¹ Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵² <http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/>

¹⁵³ Rregullore UET, neni 42.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁴ Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin; Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik; Rregullore mësimore BA Arsim Parashkollor.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

nga publiku.	viheshin në dispozicion studentëve në intranetin e UET.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	U evidentua nga biseda me përgjegjësën e DPES se programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kritereve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe të cilat më pas miratoheshin në Senatin Akademik. Konstatuam se numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhej publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. ¹⁵⁵
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ mbështetur në dokumentacion konfirmon që kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve janë hartuar në përputhje me aktet nënligjore të MASR. Institucioni pranon në të gjitha programet e tij Bachelor, studentë ndërkombëtarë që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurën e regjistrimit, por ky është një numër i kufizuar studentësh, bazuar në kuotat e pranimit për studentë të huaj të aprovuar nga MASR. Pranimi në këtë cikël studimesh realizohet përmes portalit U-Albania. Në dokumentat rregullatore të institucionit përfshihej përveç shtetasve shqiptarë edhe regjistrimi i shtetasve të huaj. ¹⁵⁶
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzoi publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në IAL u informua se në UET realizohej Java e Orientimit. Maturantët ftoheshin në kampus dhe marrin informacion të detajuar për universitetin dhe për programe specifike studimi. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maturantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit. ¹⁵⁷ ¹⁵⁸ . Konstatuam se kriteret e programeve të studimit publikoheshin dhe u vihej në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit (faqes zyrtare të UET-it online, komunikimeve ballë për ballë, Ditëve të Hapura, etj.). ¹⁵⁹ <i>Rekomandohet se institucioni duhet të zhvillojë një fushatë</i>

¹⁵⁵ Rregullore mësimore Ba Arsim Parashkollor, pika 2.4.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁶ Rregullore UET, Kreu III, neni 11.Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, pika D.I.1.2). Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁷ Politika e marketingut të programit të studimit; Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online. Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁸ Rregullores Programit të Studimit BA Arsim Parashkollor.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁹ Komunikimi i integruar i marketingut (Ref. Nr. 51); Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online. Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

	<i>më të madhe sensibilizuese me nxënësit e shkollave të mesme për tërheqjen e studentëve të rinj në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V. 2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rezultoi se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit ¹⁶⁰ dhe aktet e tjera rregullatore. Nga biseda me studentët e diplomuar të programit të studimit Ba Arsim Parashkollor, u kofirmua se studentët njiheshin me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS dhe përveç kësaj, ata mund të tërheqin nga koordinatori e Departamentit formularin e paradiplomit, ku gjendeshin të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nga takimi i zhvilluar me përfaqësuesen e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit gjatë vizitës në UET u kofirmua se kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëheshin të ditura studentëve dhe gjithashtu ishin pjesë e dokumenteve rregullatore. ¹⁶¹ Kjo realizohej nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, e cila në bashkëpunim me Departamentin bënin vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për transferimin e studimeve në institucionin e tyre. Po ashtu, nga Zyra e Karrierës dhe Praktikave bëhej informimi i studentëve të programit në lidhje me studimet Master dhe kriteret përkatëse. Edhe nga biseda me studentët e diplomuar në këtë program studimi, u aprovua se studenti i cili dëshironte të transferonte studimet në UET, informohej për të gjitha procedurat dhe kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloren e programit. ¹⁶²

¹⁶⁰ Rregullore mësimore BA Arsim Parashkollor. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶¹ Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶² Rregullore Programit të Studimit BA Arsim Parashkollor, pika 2.6. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Studentëve iu jepet gjithashtu një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit (kohëzgjatja e rregullt e studimeve, organizimi i programit, pjesëmarrja në klasë dhe vlerësimi).¹⁶³</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e UET dhe në direktivën për diplomimin. Studentët mund të diplomoheshin nëpërmjet provimit të përgjithshëm përfundimtar ose temës së diplomës.¹⁶⁴</p> <p>Për të mbështetur studentët, institucioni ka përgatitur një udhëzues specifik mbi procesin e punimit të diplomës dhe një udhëzues për provimin përfundimtar.^{165, 166}</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në takimet dhe bisedat e zhvilluara me stafin e DPES dhe me përgjegjësin e DPES, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, konfirmojmë se çdo pranverë UET-i organizonte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vizitat në shkollat e mesme të vendit (Gjinnaz tour);¹⁶⁷ • Ditët e Hapura (Open Days) ku maturantët mund të vizitonin nga afër institucionin dhe të ndjeknin orë të caktuara mësimi; • javët e regjistrimit ku u vinte në dispozicion të maturantëve grupe pedagogësh sipas fakulteteve, të cilët informonin për organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UET; • mbledhjet e hapura të Departamentit që shërbenin për informimin/diskutimin me studentët për programet e studimit; • Javën e Orientimit për studentët e rinj, përpara fillimit të vitit akademik;
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

¹⁶³ Rregullore Programit të Studimit BA Arsim Parashkollor, Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve, pika 5.

¹⁶⁴ Rregullore UET, neni 39, pika 1. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁵ Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁶ Kalendar akademik.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁷ Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve D.I.1.1.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V. 3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë dhe komunikimit me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës të orientimit. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në informacionin që përmbante faqja zyrtare e UET në internet, konfirmojmë se studenti mund të orjentohej lidhur me programin e studimit që donte të ndiqte. Përfaqësuesja e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit theksoi se programi i studimit i detajuar me lëndët dhe modulet që përmban, i jepej studentit që në momentin e regjistrimit. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihej në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen. Nga Syllabuset e vëna në dispozicion nga institucioni, konstatoam se studenti mund të gjente informacion të detajuar mbi ngarkesat përkatëse të lëndëve/moduleve, temat për çdo javë mësimore, literaturën e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, dhe nivelin e detyrueshëm i frekuentimit të lëndës. Gjatë zhvillimit të studimeve, studentëve u mundësohej akses i materialet studimore që pedagogu i lëndës vendoste në LMS, udhëzimet përkatëse për detyrat apo testimet e parashikuara. Ndërsa për studentët e vitit të dytë dhe të tretë, marrja e informacionit në momentin e përzgjedhjes së lëndëve, bëhej përmes konsultimit me pedagogun përgjegjës. ¹⁶⁸
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi	Referuar RVB dhe nga takimet me përfaqësueset e dy zyrave konfirmojmë se institucioni i kushton një vëmendje të

¹⁶⁸ Rregullorja programit të studimit BA Arsim Parashkollor, pika 3.1.6. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës. Kjo realizohej përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, të cilat zhvillinin aktivitetin e tyre në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti;¹⁶⁹ • Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbenin si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës;¹⁷⁰ • Panairëve të punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës;¹⁷¹ • Njoftimeve të studentëve mbi mundësitë për punësim; 			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në bisedat dhe takimet e zhvilluara në institucion me pedagogë të DPES u konfirmua se i gjithë informacioni në lidhje me programin e studimit, lëndët dhe modulet, u vihej studentëve që në momentin e regjistrimit.¹⁷²</p> <p>Ndërsa përmes postës elektronike dhe sistemit LMS dërgoheshin informacionet lidhur me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitetet e ndryshme që organizoheshin në UET.</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Çdo pedagog ofron komunikimin nëpërmjet LMS (Sistemit të Menaxhimit të Mësimit) dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. Studentët mund të futen me email-in e tyre në sistem ku gjejnë të gjithë informacionin. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit, pasi platforma është webbased.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V. 4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të

¹⁶⁹ Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁰ Bordi i Tregut të Punës. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷¹ Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019; Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<http://uet.edu.al/new/punimet-e-studenteve-ne-uet-perballja-e-pare-me-tregun-e-punes/>

¹⁷² Dokumenti E. I Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.1.6.3 . Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me punonjësen e Sekretarisë Mësimore dhe nga kontrolli i Regjistrit të amzës të programit të studimit Ba Arsim Parashkollor, u konstatua se institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Referuar vizitës dhe dokumentacionit numri i studentëve për tre vite akademike është:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 3 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 2 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 0 studentë;</p> <p>Programi Ba Arsim Parashkollor ka gjithsej 3 studentë të diplomuar, të cilët i përkasin gjeneratës së parë të studentëve për këtë program studimi.¹⁷³</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Punonjësja e Sekretarisë Mësimore na vuri në dispozicion statistikat e plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje) mbi ecurinë e studentëve. Nga shqyrtimi i regjistrit të këtij program studimi konstatuam se nga 5 studentë gjithsej, ishin diplomuar 3 studentë. Si nga Dekania e Fakultetit, Përgjegjësi i DPES dhe nga punonjësja e Sekretarisë Mësimore na u konfirmua se që nga viti akademik 2020-2021, në këtë program studimi nuk kishte asnjë student të regjistruar. Konstatuam se sistemi UMIS mundësonte përpunimin e të dhënave statistikore të studentëve në çdo kohë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumenteve në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve, evidentuam se çdo student kishte dosjen e tij me të gjitha të dhënat që nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Rekordet e studentit ruheshin në sistemin elektronik dhe në regjistrat përkatës.¹⁷⁴</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet</p>

¹⁷³ Cilësia në hyrje dhe dalje BA Arsim Parashkollor; Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre. Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁴ Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printoje listën e notave për studentët e vet.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjuesve.	Nga shqyrtimi i evidencave dhe raporteve të RVB-së, evidentuam se DPES analizonte dhe hartonte një raport analitik mbi arritjet e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. ¹⁷⁵ Po ashtu, Alumni interesohej dhe kishte informacion për punësimin e studentëve që mbaronin studimet për BA Arsim Parashkollor. <i>Pavarësisht kërkesës së madhe të tregut të punës për Mësues të Arsimit Parashkollor, interesi për këtë program studimi në UET, ishte tepër i ulët. Ky mosinteresim rezultoi me mosregjistrimin e asnjë studenti që nga viti 2020 në këtë program studimi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V. 5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Statuti i UET parashikon përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik; Këshillin e Etikës; Komisionin për Sigurimin e Cilësisë; dhe Këshillin e Studentëve. ¹⁷⁶
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik,	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që UET është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi gjithashtu se

¹⁷⁵ Analiza e departamentit për programin .Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁶ Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshilli Studentor funksionon dhe antarët e tij përçojnë shqetësimet e studentëve në të gjitha trupat vendimarrëse. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë, është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe adresimin më të mirë të nevojave të studentëve. Një mënyrë tjetër që përdorej për të marrë mendimin e studentëve ishin “Focus Group”-et me studentët.¹⁷⁷</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Përfaqësuesja e Zyrës së Kurrikulave dhe përgjegjësi për lëndët mësimore na siguruan se programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave asistonte nga pikëpamja teknike pedagogët e DPES duke lehtësuar llogaritjen e pikëkrediteve dhe shpërndarjen e drejtë të lëndëve nëpër semestra. Ngarkesa e shprehur në kredite bëhej sipas parimit të shpërndarjes së balancuar në semestra (<i>afërsisht 30 ECTS për semestër</i>). Në programin BA Arsim Parashkollor, sipas Rregullores së studimit, studentët duhet të plotësojnë 30 ECTS, për të kaluar në vitin e dytë dhe 60 ECTS për të kaluar në vitin e tretë. Në semestrin e dytë të vitit të tretë, studentët ndjekin 3 lëndë, duke qenë se i krijohen lehtësira për tu angazhuar në praktikën profesionale dhe detyrimet përmblyëse të programit.¹⁷⁸</p> <p>Për studentët të cilët preferonin transferimin e studimeve të tyre në UET, kriteret dhe procedurat që ndiqen në këtë rast janë të parashikuara në dokumentet rregullatorë të institucionit.¹⁷⁹ Nga vizita e zhvilluar në institucion, rezultoi se një studente kishte transferuar studimet e saj nga Univeristeti i Korçës në UET në programin Ba Arsim Parashkollor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e</p>	<p>Mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, UET-i garantonte përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Kjo përfshirje realizohej përmes pyetësorit me studentët dhe fokus grupeve. Sipas përfaqësueses së Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), pyetësori</p>

¹⁷⁷ Rregullore UET, Neni 22,pika2. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁸ Ba Arsim Parashkollor_Plani mesimor.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁹ Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve; Rregullore UET, Kreu VII, Neni 35. Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

tyre në to.	organizohej dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Ndërsa fokus-grupet zhvilloheshin në janar të çdo viti. Gjithashtu, mbledhjet e hapura të departamenteve shërbenin si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në takimet me pedagogët departamentit të këtij programi studimi si dhe nga shqyrtimi i evidencave të siguruar nga institucioni, konstatohet se mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve ishte një proces transparent, i cili shprehej në rregulloret e brendshme ¹⁸⁰ sikurse dhe në silabusin e secilës lëndë. ¹⁸¹ Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, ishin tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Përmes plotësimit të formularëve përkatës, studentët kishin mundësi të parashtronin kërkesat e tyre në rsat ankimimi. ¹⁸²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V. 6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Sipas përfaqësueses së Zyrës së Kujdesit ndaj Studentëve, njësia e posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në UET ishte pikërisht kjo zyrë. ¹⁸³ Ajo na konfirmoi se puna në këtë zyrë ishte shumë intensive dhe fillonte që nga momenti i regjistrimit të studentit, me ndjekjen e ecurisë së studimeve në vite, dhe deri në diplomimin e tij. Kjo zyrë ofronte konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Gjithashtu në shërbim të

¹⁸⁰ Rregullore UET, Neni 24, 27 dhe 32. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸¹ Format i silabusit cikli i pare dhe dyte.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸² D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.Rregullore mësimore Ba Arsimit Parashkollor, pika 5.3.4 dhe pika 5.7.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸³ Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	informimit e shërbimit të studentëve ishte Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departamenti. ¹⁸⁴
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Evidentua se kishte një kombinimin të aktivitetit ndërmjet zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në secilin departament, të cilët tregonin për funksionimin e një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	U konfirmua nga përfaqësuesja e Zyrës së Karrierës dhe Praktikave se kjo zyrë ishte në shërbim të studentëve duke ofruar këshillim karriere, informacion për punësimin apo rreth aktiviteteve studentore brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Panairët e ndryshme për punësim që organizoheshin nga UET-i, u jepnin mundësi informimi studentëve mbi tregun e punës. Rezultoi se kjo zyrë kishte krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunonte ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve ¹⁸⁵ , por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto institucione. DPES kishte një pedagog si Këshillues Karriere, i cili u jepte njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe karrierës së studentëve. ¹⁸⁶
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga biseda me përfaqësuesen e ZKK-së, rezultoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës si dhe Alumni mbanin kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. ¹⁸⁷ Shoqata Alumni zhvillonte takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në programet e studimit për t'iu përshtatur

¹⁸⁴ Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁵ Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.2. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁶ Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.1.d. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁷ Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë. ¹⁸⁸ Studentë Alumni ishin të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve dhe jepnin asistencën e tyre si më lart.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni (Statuti, Rregullorja), konstatohet se UET i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit. ¹⁸⁹ Kujdes i kushtohej zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokus të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet. ¹⁹⁰
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku	Sipas deklarimit të Kryetares së KSBC-së, sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksiononte nëpërmjet këtyre strukturave: <ul style="list-style-type: none"> Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i cili e kishte nisur punën fillimisht në formën

¹⁸⁸ <http://uet.edu.al/new/uet-alumni-10-vite-me-pas/>

¹⁸⁹ Statuti UET, Neni 11&16 (Ref. Nr. 2); Rregullore UET, Neni 6; Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8). Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁰ Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", Neni 103 .VKM Nr. 531, date 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

<p>përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>e grupeve <i>ad hoc</i> dhe që nga Janari 2011 funksiononte si njësi e përhershme në organikën e institucionit.¹⁹¹ KSBC-ja vlerësohte periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET-it dhe kishte akses në të gjitha të dhënat e institucionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bordet e Tregut të Punës, të cilat shërbenin si organe këshilluese si dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm plotësohte nevojën e Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë sipas kërkesave të tregut të punës; • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës ishte të zhvillonte politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si dhe të monitoronte zbatueshmërinë e tyre nga njësitë akademike dhe administrative të institucionit.¹⁹²
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Bazuar në bisedën me përfaqësuesen e KSBC-së dhe me Përgjegjësin e DPES, rezultoi se sigurimi i cilësisë realizohej përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e ZCS, KSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe strukturave të tjera shtetërore. UET i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe akreditimin periodik Institucional, me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike.¹⁹³ Programet e tjera të studimit i janë nënshtruar procesit të akreditimit në mënyrë periodike në kuadër të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë.¹⁹⁴ Ky program po vlerësohet për herë të parë në kuadër të akreditimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave të RVB-së dhe nga takimi me përfaqësuesen e KSBC-së, konstatuam se veprimtaria e KSBC mbështetej në dokumentin e saj strategjik¹⁹⁵, e cila</p>

¹⁹¹ Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks; Urdhër mbi përbërjen e KSBC.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹² Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.5. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹³ VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë UET"; VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 "Për akreditimin e Universitetit European të Tiranës"; Certifikatë akreditimi UET. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁴ Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga departamenti_Tabela 3 Aneks.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁵ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	hartohej nga kjo njësi dhe zhvillohej e organizuar sipas një plani kalendar ¹⁹⁶ të përvitshëm, në të cilin programoheshin sektorët apo proceset që i nënshtroheshin vlerësimit të cilat shoqëroheshin me raportet dhe gjetjet përkatëse. Periodikisht KSBC informonte drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara. Qëllimi ishte marrja e masave për përmirësimin e performances së institucionit, njësive bazë dhe individëve të saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI. 2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Nga evidencat e vëna në dispozicion si dhe nga shqyrtimi i RVB-së, konstatoam se UET-i kishte ngritur KSBC-në e cila vepronte në nivel institucional dhe ishte përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në nivel njësie bazë, DPES kishte përgjegjësit e gruplëndëve/koordinatorët ¹⁹⁷ e programeve të cilët ishin përgjegjës për rishikimin e kurrikulës, silabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore. Në funksion të garantimit të cilësisë ishin Standardet dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së UET. ¹⁹⁸ Bordet e Tregut të Punës reflektonin dinamikat dhe kërkesat që vinin nga tregu dhe rekomandimet e tyre vlenin për ndryshime në kurrikula. ¹⁹⁹
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme	Nga shqyrtimi i evidencave të RVB-së konstatoam se KSBC-ja përgatiste dhe shpërndante raportet e vlerësimeve periodike lidhur me shqyrtimin e silabuseve të programeve të studimit. Këto raporte u viheshin në dispozicion strukturave drejtuese, përgjegjësve të departamenteve dhe pedagogëve

¹⁹⁶ Plani i veprimit KSBC. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁷ Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁸ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁹ Dokumenti E.VIII. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, Pika E.VII.4.1.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

të programeve të studimeve të ciklit të parë.	dhe ishin pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati dhe Departamenti. ²⁰⁰			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar mbi shqyrtimin e Raporteve vjetore dhe evidencave të Vlerësimit të Brendshëm, evidentuam se UET përdor instrumente matëse për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues organizoheshin nga KSBC. ²⁰¹			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Konstatohet se rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, në formën e një dokumenti zyrtar, u bëheshin të njohur përgjegjësit të departamentit, përgjegjësve të grup-lëndëve/koordinatorëve dhe titullarit të lëndës. ²⁰²			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion, vërtetohet se Raportet e vlerësimit vinin në pah përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. ²⁰³ KSBC-ja monitoronte procesin e marrjes së masave me qëllim adresimin e mangësive dhe korrigjimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI. 3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të	Rezulton nga analiza e dokumentacionit të KSBC-së se çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Raporti Vjetor i Institucionit. Bazuar mbi këtë raport, DPES evidentonte elementët që lidheshin me programin Ba Arsim Parashkollor dhe bashkë me rezultatet nga pyetësorët me studentët, hartonte Analizën vjetore të DPES duke bërë një vetëvlerësim të këtij programi studimi.

²⁰⁰ Metodologjia e punës së KSBC_Provimet; Format Raporti_Provimet. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰¹ Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰² Format i relacionit për monitorimin e silabuseve). Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰³ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave të RVB-së dhe nga biseda e zhvilluar me kryetaren e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë konstatohet se institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdorte metoda dhe instrumente të ndryshme, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • monitorimin e çështjeve të lidhura me proceset akademike ku bëjnë pjesë: provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj;²⁰⁴ • zhvillimin e pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve; • përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit (në strukturën e KSBC është një përfaqësues i Këshillit të Studentëve);²⁰⁵
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidentuar se UET në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara; - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me pikë; - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë; - Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvilloheshin vizitat nga epori (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi dhe procesi përfundonte me plotësimin e një raporti vlerësimi.²⁰⁶</p> <p>Në kushtet e zhvillimit të mësimin online me anë të platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas Vendimit të Senatit Akademik²⁰⁷, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT në UET</p>

²⁰⁴ Plani i veprimit KSBC. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁵ Të dhëna për anëtarët e NJSBC.Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁶ G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁷ Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi: aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët, prezencën në mësim, kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Nga evidencat e vëna në dispozicion nga institucioni, konstatohet se UET kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.²⁰⁸</p> <p>Metodat e tërthorta përfshinin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve. • Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit. • Pyetje konceptuale. • Intervista me studentët dhe pedagogët. <p>Rezultatet e tyre u vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të zhvillojë sondazhe ose/dhe intervista të personelit ndihmës akademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI. 4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në</p>	<p>Bazuar mbi Statutin e UET, Rregulloren e UET, Rregulloren</p>

²⁰⁸ G.III.4.2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>e Programit të Studimit Ba Arsim Parashkollor, Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë²⁰⁹, rezulton se institucioni sanksionon përfshirjen e aktorëve të ndryshme, të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë në këtë program studimi. Kjo sigurohet përmes ngritjes pranë departamenteve të organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës; përfshirjes dhe angazhimit në KSBC të një eksperti të jashtëm²¹⁰.</p> <p>Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka siguruar përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kishin në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti Erasmus+ QAINAL.²¹¹ Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ të Universitetit – me focus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1.²¹²</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Konstatuam se përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktoheshin në aktet rregullatore të Universitetit²¹³ dhe detyrimet dhe përgjegjësitë konkrete institucionale kryheshin nga çdo njësi: departamenti, koordinatori i programit, zyra e karrierës, sekretaria mësimore, stafi akademik.²¹⁴ Sinkronizimin e veprimtarisë së secilës njësi e garantonte KSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me kryetaren e KSBC-së dhe nga shqyrtimi i dokumentit që rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, evidentuam se aty përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar²¹⁵. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhej nga 11 anëtarë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryetarja e Komisionit • një përfaqësues nga pedagogët e çdo fakulteti

²⁰⁹ Statuti UET (Ref. Nr. 2); Rregullore e UET.Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.Rregullore e Programit të Studimit Ba Arsim Parashkollor.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁰ Të dhëna për anëtarët e NJSBC.Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

²¹¹ Fisha e projektit ENCHASE; Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 30.10). Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹² Projektet UET 2014 – 2020.<https://uet.edu.al/completed-projects/>; <https://uet.edu.al/active-projects/>.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

²¹³ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁴ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6.Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit. Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁵ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

programit të studimit.	<ul style="list-style-type: none"> • një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrativ • një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe • një përfaqësues ekspert i jashtëm. 								
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe akteve të tjera rregullatore, konfirmojmë se ky kriter përmbushet dhe për zgjedhja e anëtarëve të KSBC-së bëhej duke marrë parasysh këto kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetencat profesionale - Paanshmëria; - Mundësitë për grumbullimin e informacionit për vlerësimin; - Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; - Mos qenia pjesë e autoriteteve drejtuese të UET.²¹⁶ 								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Evidentojmë se angazhimi i ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, realizohej nëpërmjet takimeve të tij me Bordin e Tregut të Punës²¹⁷. Tregues tjetër i angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, ishin edhe pjesëmarrjet që UET-i ka patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.²¹⁸</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI. 5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia,	Rezulton se institucioni ka bërë publike për studentët dhe të

²¹⁶ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.7.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁷ Të dhëna për anëtarët e NJSBC; Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC.Bordi i Tregut të Punës.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁸ Fisha e projektit ENCHASE ; Fisha e projektit QainAL.Parë në Prill 2022, gjenden në: <https://ascal.al/sq>

<p>organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të tij, Statutin, Rregulloren, të gjithë vendimet e marra nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Faqja zyrtare e UET publikon rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, duke marrë parasysh dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion konstatohet se pas kryerjes së vlerësimit nga KSBC, përpilohej një raport i cili u shpërndahej departamenteve me qëllim që të merrnin masat për përmirësimin e atyre elementëve që kishin nevojë.²¹⁹</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam se UET vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të gruplëndëve²²⁰ e koordinatorit të programit²²¹, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave²²², Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.²²³</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga diskutimet e zhvilluara në takimet e drejtpërdrejta me KSBC dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të RVB-së rezulton se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

²¹⁹ Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁰ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²¹ Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit. Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²² Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²³ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.Parë në Prill 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Arsim Parashkollor”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi Bachelor në “Arsim Parashkollor” që zbatohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale pranë Universitetit Europian të Tiranës është zbatuar me korrektësi nga institucioni konform licensimit të këtij programi;
2. UET zbaton akte normative konform ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore të MASR, por dhe ato të hartuara nga vetë IAL që kanë lehtësuar zbatimin efektiv të programit;
3. UET ka infrastrukturë fizike, ndihmëse, sisteme dhe platformë online që lehtësojnë zbatimin e programit, por dhe kërkesat e nevojat e studentëve;
4. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësirat e duhura për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në “Arsim Parashkollor”, duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infrastrukturor për student;
5. Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale pranë Universitetit Europian të Tiranës ka kapacitete njerëzore të mirëkualifikuar me grada e tituj shkencor që e realizojnë profesionalisht zbatimin e programit;

b. Pika të dobta:

1. Mungesa e një strategjie të efektshme për promovimin dhe rritjen e numrit të studentëve në këtë program;
2. Mungesë e pjesshme e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe;

Rekomandime:

1. Rekomandohet që te programet lëndore të shtohet një element në strukturë lidhur me

- Kodin e Etikës;
2. Rekomandohet përditësimi i literaturës së detyruar në gjuhën shqipe që lidhet me programin e studimit;
 3. Rekomandohet që raporti i analizës së pyetësorëve të botohet edhe në faqen zyrtare të UET, ku mund të aksesohet me lehtësi si nga studentët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar;
 4. Rekomandohet se institucioni duhet të zhvillojë një fushatë më të madhe sensibilizuese me nxënësit e shkollave të mesme për tërheqjen e studentëve të rinj në këtë program studimi;
 5. Rekomandohet që Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve të hartojë dhe të zbatojë një strategji të mirëmenduar dhe me plan veprimi, konkret dhe efektiv për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Arsimin Parashkollor" dhe mosmbylljen e programit;
 6. Rekomandohet që institucioni të zhvillojë sondazhe ose/dhe intervista të personelit ndihmës akademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studimi;



Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Preschool Education"

a. Strengths and affirmations:

1. The Bachelor program in "Preschool Education" implemented by the Department of Psychology, Education and Sports of the Faculty of Humanities, Education and Liberal Arts at the European University of Tirana has been implemented correctly by the institution in accordance with the licensing of this program;
2. UET implements normative acts in accordance with the law on higher education and bylaws of MASR, but also those drafted by the HEIs themselves that have facilitated the effective implementation of the program;
3. UET has physical infrastructure, auxiliary infrastructure, systems and online platforms that facilitate the implementation of the program, but also the requirements and needs of students;
4. The Faculty of Humanities, Education and Arts has the infrastructure capacity and the necessary space to accommodate students of the Bachelor program in "Preschool Education", thus meeting the standards of infrastructure capacity per student;
5. The Department of Psychology, Education and Sports of the Faculty of Humanities, Education and Liberal Arts at the European University of Tirana has well-qualified human capacities with degrees and scientific titles that professionally implement the program;

b. Weak points:

1. Lack of an effective strategy implementation for promoting and increasing the number of students in this program;
2. The compulsory literature in the Albanian language, is partially lacking;




Recommendations:

1. It is recommended to add an element in the structure related to the Code of Ethics to the subject programs.
2. It is recommended to update the compulsory literature in Albanian language related to the study program.
3. It is recommended that the questionnaire analysis report be published on the official website of UET, where it can be easily accessed by students and any other interested person.
4. It is recommended that the institution should conduct a larger awareness campaign with high school students to attract new students to this study program.
5. It is recommended that the Department of Psychology, Education and Sports to design and implement a well-thought-out strategy with action plan, concrete and effective for increasing the number of students enrolled in the Bachelor study program in "Preschool Education" and not closing the program .
6. It is recommended that the institution conduct surveys and / or interviews of academic support staff as well as other collaborators who contribute to the implementation of this study program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X	



IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

